



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË FIER

Nr. 6318/Prot
3

Fier më, 03/06/2026

PROCESVERBAL

Mbledhja e Këshillit të Bashkisë datë 28.05.2026. Sot në sallën e mbledhjeve ora 11:00. Të pranishëm në mbledhje 37 këshilltarë.

Z.Melsi Bogdani

Të nderuar këshilltarë! Në mbështetje të nenit 56 pika 2, shkronja a të ligjit 139 të vitit 2015 zhvillojmë sot mbledhjen e radhës këshillit me këtë rend dite. Përpara se të kalojmë rendin e ditës, kemi një kemi një propozim për t'u futur në rendin e ditës propozimin për ndryshim të rendit ditës për mbledhjen plenare të radhës. Kryesia e këshillit e mbledhur sot më datë nën drejtimi nën datë 28 I pesti 2026 nën drejtimin e kryetarit të këshillit në mbështetje të ligjit 139 2015 për vetëqeverisjen vendore I ndryshuar në zbatim të rregullores për funksionimin e këshillit bashkiak fier miratuar me vkb datë 27 I pesëmbëdhjetit 2020 konkretisht kreu dy neni 22 pikat një dhe tre mbi kompetencat e kryesisë për të organizuar punët e këshillit dhe të miratuar rendin e ditës neni 66 pikat shtatë tetë 11 12 dhe 13 neni 92 pikat pesë dhe shtatë mbi procedurat e dorëzimit të projektakteve për shqyrtim në këshillin bashkiak pas shqyrtimit të kërkesës për trajtimin e projektaktit dhënie titulli qytetar nderi I cili vlerësohet si rëndësisë veçantë për interesat e bashkisë të miratojë vendosi të miratojë propozimin për shtimin në rendin e ditës të mbledhjes plenare të datës 28 05 2026 projektvendimin për dhënien e titullit qytetar nderi. Kryesia vlerëson se ky akt duhet përfshihet në rendin e ditës jashtë afateve standarde të njoftimit për shkak të tejzgjatjes procedurës të deritanishme. Ngarkohet sekretaria e këshillit që krahas njoftimit standard tu vërë në dispozicion anëtarëve të këshillit materialin shoqërues relacionin mbështetës menjëherë për të garantuar kohën e mjaftueshme.

Znj.Antoneta Çunaj

Me leje?

Z.Melsi Bogdani

Po.

Znj.Antoneta Çunaj

1

Tani ju si kryetar i këshillit jeni zotuar përpara këtij këshilli se do të zbatoni rregulloren. Rregullorja në rendin e ditës parashikon vetëm 15 pika në rend të ditës. Një nga arsyet ku ju insistuat se unë unë kisha shkelur rregulloren ishte se miratoja mbi 15 pika të rendit të ditës. Aktualisht rendi I ditës që vjen sot për shqyrtim është me 16 pika. Por më vjen keq që që këshilli bashkiak vazhdon përsëri të shkelë rregulloren për përcaktimin tej tej numrit të përcaktuar në rregullore që është 15 dhe për këtë shkak u mor masa. Dhe për këtë qëllim unë kërkuj po përsëritet përsëri që rendi I ditës të mos jetë me 15 pika në rendin e ditës por të jetë më tepër se 15 pikë është aktualisht është 16. Kështu është de një saktësim. Pra këtë kisha unë të shihja çfarë kishit miratuar ju. Dhe jam dakord. Por me kushtit dhe të them më mbrapa kur të miratohet rendi I ditës për t'u hequr dy pika të rendit të ditës janë futur në këtë në këtë mbledhje janë futur në kundërshtim të hapur me ligjin. Dhe këtu do të diskutojmë më mbrapa. Për ata ëndërroj që të marrin qytetarë nderi dhe e kam dashur. Por më vjen keq që ndodhen në këtë pozicion.

Z.Melsi Bogdani

Shumë faleminderit Neta, shumë faleminderit të presim të hidhet rendi I ditës të kalojë dhe do shikoni se sa pika do të ngelen në rendin e ditës pastaj mund ta bëni këtë citimin përse I përket pjesës së rendit të ditës. Atëherë jeni kush është dakord për futjen jashtë radhe në rendin e ditës.

Z.Gëzim Hajdëraj

Më fal Zoti kryetar! Përpara se të kaloni në votim, kam një ndërhyrje për procedurë. Unë kam një mendim dhe nuk e kuptoj se pse nuk hidhen dhe nuk pasqyrohen problemet kryesore që ka qyteti I Fierit në rendin e ditës. Konkretisht janë dy probleme kryesore që duhet të ishin në rendin e ditës. Së pari e është fakti që klubi i apolonisë së Fierit ka rënë në kategorinë e tretë. Nuk e di dhe habitem se si kalohet në heshtje kjo gjë dhe nuk kalohet në rendin e ditës dhe duhet patjetër patjetër që të të zgjidhet ky problem në mënyrë institucionale. Sepse është e pafalshme për një qytet të tillë si Fieri që për herë të parë zbret në kategorinë e tretë. Unë e quaj një ngjarje të jashtëzakonshme dhe qyteti I fierit dhe gjithmonë ka patur sporte primaretë të gjitha fushat aq më tepër në futboll dhe aktualisht kemi arritur në këtë gjendje dhe për mua kjo duhet të ishte pika e parë e rendit të ditës. Si sillet ky klub? Si mund të kalohet që të bjerë klubi I apolonisë në kategori të tretë atje? Milani pse nuk u kualifikua në Champions League u shkarkuan gjithë ato veta, Fieri shkon në kategorinë e tretë nuk merret asnjë masë, asnjë gjë. Unë mendoj se duhet të ishte pikë e parë e rendit të ditës. Gjithashtu duke qenë se edhe mediat janë këtu, mendoj që media e ka kaluar me heshtje duke u pajtuar me qëndrimin indiferent ndaj këtij fakti. Media duhet ta kishte trajtuar ndryshe këtë fakt. Klubi ka përgjegjësi dhe kush e drejton klubin duhet të mbajë përgjegjësi.

Problemi I dytë që dua të ishte patjetër në rendin e ditës, të cilin unë e kam ngritur me kohë por asnjëherë nuk më ka dëgjuar është fakti se problematikat trajtohen në bazë të kohës.

Problematika kryesore tani është sezoni veror. Sezoni veror është problematik veçanërisht për fierin I cili është qytet bregdetar. Që ditën e parë që kam qenë prezent në këtë këshill unë e kam

2

ngritur që bashkia fieri është bashkia më e prapambetur në drejtim të kushteve për shfrytëzimin e plazhit. Është e vetmja bashki që më në fund bëri një rrugë edhe pse jo në standardet e duhura kurse të gjithë rrugët e tjera për të vajtur në plazh janë jashtë çdo standardi. Nuk e di ku I bëni pushimet ju po unë I bëj këtu në fier dhe po të vëni në darëzezë apo në Seman ajo rruga është nuk e di çfarë të them . Prandaj unë mendoja që duhet ishte patjetër këto dy problematika duhet të ishin patjetër rendin e ditës. Unë mendoj dhe i propozoj këshilltarëve që ne ti fusim këto dy probleme në rendin e ditës. Faleminderit!

Z.Melsi Bogdani

Koleg në pikën në pikën katër të rendit ditës është një nga që do kalojmë sot është një nga pikat paraqitja e këshilltarëve për çështjet dhe problematikat. Mund ta ngrini në pikën katër dhe në dhe propozimet përkatëse t'I sillni për mbledhjen e radhës dhe me gjithë dashamirësinë e madhe mund të futen në rendin e ditës. Atëherë e hedhim rendin e ditës. Po?

Z.Illia Fili

Zoti kryetar?

Z.Melsi Bogdani

Po

Z.Illia Fili

Në lidhje me atë propozimin që bëtë ju, për shqyrtimin e propozimit të dhënës së titullit të nderit të atyre artistëve, për një diçka dua të sqarohem.Di që ka qënë një propozim nga shoqata e Fierakëve në emigrim” Apollonia” në Athinë për dy qytetarë, ndërkohë që ju po thoni që ka ardhur dhe një propozim tjetër, dhe ne tani do të shqyrtojmë dy propozime?

Z.Melsi Bogdani


Jo, një propozim . Do të dali me një, do ta lexosh në...

Z.Illia Fili

N.q.s ju i keni bashkuar ato, atëherë unë dua të di edhe mendimin e shoqatës. A është dakort shoqata që të bashkohet propozimi i tyre me këtë propozim?Apo ata qëndrojnë në propozimin e tyre për dy persona.

Z.Kreshnik Dapi

Kryetar, me leje?



Z.Melsi Bogdani

Po.

Z.Kreshnik Dapi

Me respekt të fjalës së parafolësit dhe në përgjigje të koleges të Znj. Çunaj në cilësinë e sekretarit të kryesisë së këshillit dua t'ju bëj me dije që në datën 18.05.2026 për herë të parë në historinë e kësaj legjislature mbledhja e kryesisë së këshillit bashkiak fier është zhvilluar në një formë të gjitha ligjeve dhe kritereve të përcaktuara në rregulloren e këshillit bashkiak. Për herë të parë ne kemi në tavolinën e punës në këtë mbledhje gjashtëmbëdhjetë pikat e rendit të ditës të rregullta në formë me përmbajtje siç e do ligji ashtu siç e theksoi dhe kryetari I këshillit kolegët mos të nxitohen sepse gjatë kësaj mbledhje ne kemi parashikuar dhe zhvillime të tjera. Mund të kemi dhe ndonjë tërheqje pike në rendin e ditës prandaj e dhamë qëllimisht 16 pavarësisht se mund të biem dhe në atë numër. Gjithashtu në përgjigje të kolegut zotit Hajdaraj dua t'ju bëj me dije që po ashtu për herë të parë është zbatuar me rigorozitet neni 67 I rregullores së këshillit bashkiak I cili jep formatin zyrtar të rendit të ditës. Siç e keni parë pika katër është një prej tyre është pika ku për një periudhë prej 30 minutash administrata e bashkisë do të mbajë shënim të gjitha vërejtjet propozimet dhe kërkesat që sjellim nga këshilltarët nga komunitetet e tyre përkatëse në territor. Për pjesën e propozimit për qytetarët e nderit duke qenë se jam një nga firmëtarët e këtij projektvendimi dhe firmëtar i këtij propozimi dua t'I them kolegut që propozimi I grupit tonë politik partisë socialdemokrate nuk bie ndesh me propozimin e shoqatës apolonia kjo çështje I ka kaluar komisionit përkatës të titujve. Komisioni në të gjithë të drejtat dhe kompetencat që i jep rregullorja, I ka shqyrtuar të dyja kërkesat dhe pasi I ka gjetur të mbështetura në ligj, ka propozuar, ka dal me vendimmarrje, ka propozuar dhënie titullit, titulli qytetar nderi për të gjashtë themeluesit e grupit kënga qytetare fierake , ku dy nga të cilët ishin propozuar që në nëntor të vitit 2025 nga zonja kolegja Elida Sopotit dhe shoqata bashkimi I emigrantëve fierakë në greqi, apolonia. Ju ftoj në parantezë të kësaj pike ju ftoj të gjithë ta votojmë bashkërisht këtë pikë shtesë. Faleminderit.

Z.Melsi Bogdani

Elida meqënëse të kërkoi inxhinieri...

Znj.Elida Sopotit

Atëherë përshëndetje dhe nga unë, nuk po e zgjas shumë. Siç e dini propozimi i shoqatës apolonia ka ardhur që në nëntor të 2025-ës dhe për arsye të ndryshme u shty. Neve kemi rënë dakord bashkë në mbledhjen e kryesisë që të jepet qytetarë nderi dhe për personat e tjerë të propozuar nga kolegu ynë, Niku. Por e kemi lënë që propozimi I shoqatës apolonia të shqyrtohet në fillim dhe të votohen të parët pastaj të tjerët të votohen në pas. Ky ka qenë propozimi ynë dhe

unë kam rënë dakord që zoti Miti Nushi dhe Llazer Pove si propozimi i shoqatës apolonia , të votohen të parët dhe pastaj kolegët e tyre. Shumë faleminderit.

Z.Melsi Bogdani

Atëherë që të marrë formë kjo pjesë dhe të përfundojë, sepse propozimi ka qenë, ne me Elidën si propozuese e 14 nëntor dhe si tejzgjatje në dy seanca dhe nuk gjetëm dakordësinë. Përfundimisht ramë parimisht dakord, të dyja propozimet të dalin në një vendim të përbashkët se nuk mund të dalin në dy vendime dhe të dyja propozimet të lexohen veç e veç, propozimin e shoqatës apollonia me dakordësinë e Elidës si dhe propozimin e grupit të PSD-së për katër pjesëtarët e tjerë të grupit. Në qoftë se keni paqartësi tjetër para se ta hedh në votim, më thoni në qoftë se keni ndonjë merak tjetër për këtë pikë?

Nuk keni, e hedhim në votë, kush është dakord që pika shtesë të kalojë?Kartonat

Znj.Antoneta Çunaj

Unë jam pjesërisht, vetëm për të parën, për atë të shoqatës “apolonia” me Lidën, ndërsa për pjesën tjetër dua materialet se nuk e është materiali i plotë. Për pjesën e dytë zoti kryetar kërkoj materialet të cilat janë të pashpërndara. Ne nuk kemi marrë informacion, për pikën, për pjesën e dytë të shtesës së rendit të ditës. Për pjesën e parë të propozimit nga shoqata “Apolonia” dhe që ka bërë Elida Sopot, po jam shumë dakord, sepse i kemi lodhur shumë dhe e kemi vonuar. Për pjesën e dytë kërkoj materialet

Z.Melsi Bogdani

Në sallë, në sallë janë 36 këshilltarë aktualisht nga të cilat me përjashtim të avokatit që nuk mori... a ok, atëherë 36 vota pro.

Pro 36 vota.

Kundra s`ka.

Abstenim s`ka.

Miratohet futja e pikës shtesë në rendin e ditës.

Tani kalojmë në miratimin e rendit të ditës së bashku me pikën shtesë.

Pika e parë e rendit të ditës.

Miratimi i rendit të ditës me përmbajtjen si më poshtë:

1. Miratimi i Rendit të Ditës.
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Këshillit, datë 30.04.2026.
3. Projektvendim "Për dhënieën e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin prill 2026"

4. Paraqitja nga Këshilltarët e Çështjeve dhe Problematikave të Komunitetit
5. Projektvendim Për dhënien e ndihmës shtetërore financiare të shtetas Lindita Lako"
6. Projektvendim "Për miratimin e pagesës së shpenzimeve të varrimit të ndjerës Hava Alushi"
7. Projektvendim Për pranimin në shtëpinë e të moshuarve të z.Rrapo Pashaj"
8. Projektvendim Për miratimin e përfundimit të procedurave të apartamentit për familjen e shtetasit Todit Silli Llagoni".
9. Projektvendim Për dhënien e miratimit të ekzekutivit të Bashkisë për fillimin e procedurave të prishjes së objektit shkolla e vjetër 9 vjeçare " Lili Stravre",Topojë.
10. Projektvendim " Per disa shtesa dhe ndryshime në V.K.B Nr.109 datë 27.11.2025 " Mbi strukturën dhe nivelin e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Fier për vitin 2026" |
11. Projektvendim "Per shyrtrimin dhe miratimin e kërkesës për pajisjen me zyre vendore të Partisë Socialdemokrate të Shqipëris"
12. Projektvendim "Për miratimin e raportit tekniko-ekonomik për dhënien në përdorim të fondit pyjor në pronësi publike të Bashkisë Fier për shtrirjen e linjës së ujësjellësit Patos"
13. Projektvendim "Për detajimin dhe përdorimin e fondit Lë kushtëzuar për mbrojtje civile"
14. Projektvendim " Per miratimin e planit të arsimit parauniversitar 2026-2030 të Bashkisë Fier"
15. Projektvendim "Për miratimin e pasqyrave financiare të konsoliduara për vitin 2025 të Bashkisë Fier dhe institucioneve vartëse"
16. Projektvendim " Per miratimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2025 të shoqërisë "Apollonia" sh.a." Diskutime dhe komente.

Pika e parë shtesë e rendit të ditës.

Projektvendimin për dhënien e titullit qytetar nderi.

Z. Ilia Fili

Më fal, kryetar, një second të lutem, mqs jam më I vjetri këtu, sepse ju nuk I vutë në dijeni kolegët që ne përpara disa ditësh ishum në Vlorë, në një takim me këshillin bashkiak, dhe po u bëj me dije kolegëve që në atë takim, sapo u ulëm, na erdhën secilit nga ne nga një shishe me ujë. Dhe këtu mori shëmbull bashkia e Fierit dhe sot këtu ka sjellë disa bidona ujë, një e kemi ne të opozitës këtu, dhe nja 4 te grupit i PS-së , nga një për 3-4 veta.

Z.Melsi Bogdani

Do shikohet, ke shumë të drejtë inxhinier, do ta shikojmë. Atëherë kalojmë në miratimin e rendit të ditës.

Pika e parë e rendit të ditës.

Miratimi i Rendit të Ditës.

Z.Melsi Bogdani

Në mbështetje të nenit 53, pika 4, nenit 56, pika 2, shkronja a të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” I ndryshuar, ju njoftojmë thirrjen e mbledhjes së radhës së këshillit bashkiak në sallën e këshillit ditën e enjte 28.05., ora 11:00 me këtë rend dite:

Miratimi I rendit të ditës.

Miratimi I procesverbalit të këshillit datë 30.04.2026.

3. Projektvendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi I kushtëzuar 6% për muajin prill 2026”.

4. Paraqitja nga këshilltarët e çështjeve dhe problematikave të komunitetit.

5. Projektvendim “Për dhënien e ndihmës shtetërore financiare të shtetases Lindita Lako”.

6. Projektvendim “Për miratimin e pagesës së shpenzimeve të varrimit të ndjerës Hava Lushi”.

7. Projektvendim “Për pranimin në shtëpinë e të moshuarve të zotit Rrapo Pashaj”.

8. Projektvendim “Për miratimin e përfundimit të procedurave të apartamentit për familjen e shtetasit Todi Silli Langoni”.

9. Projektvendim “Për dhënien e miratimit ekzekutiv të bashkisë për fillimin e procedurave të prishjes së objektit shkolla nëntëvjeçare ‘Lili Stavre’, Topojë”.

10. Projektvendim “Për disa shtesa dhe ndryshime në vkb-në numër 109, datë 27.11.2025 ‘Mbi strukturën dhe nivelin e taksave dhe tarifave vendore të bashkisë fier për vitin 2026”

Për këtë pikë të nderuar këshilltarë, nga ekzekutivi I bashkisë, nga kryetari I bashkisë me shkresën 6362 datë 19.05.2026 për vënien në dispozicion të materialeve dhe akteve

7

administrative, I është kërkuar kryetarit të këshillit. Në datën 25.05.2026 me numër protokollit 6362 fraksion 1, kryetari I këshillit I ka vënë në dispozicion të gjithë procedurën për pikën 10 dhe sipas nenit 96 të rregullores, e drejta e kryetarit ka 20 ditë për kthimin e përgjigjes, për kthimin, për dhënien e mendimit, bazuar në nenin 96 të rregullores së këshillit bashkiak. Kështu që për këtë pikë ia jap fjalën kryetarit të grupit të Partisë Socialiste, zotit Marius Voja.

Z.Marjus Voja

Propozoj që pikën 10 të rendit të ditës ta tërheqim për ta shqyrtuar në mbledhjen e ardhshme për shkak të mungesës së dokumentacionit.

Faleminderit!

Z.Melsi Bogdani

11. projektvendim “Për shqyrtimin dhe miratimin e kërkesës për pajisje me zyrë vendore të partisë socialdemokrate të shqipërisë”.

12. Projektvendim “Për miratimin e raportit tekniko-ekonomik për dhënien në përdorim të fondit pyjor në pronësi publike të bashkisë fier për shtrirjen e linjës së ujësjellësit patos”.

13. Projektvendim “Për detajimin dhe përdorimin e fondit të kushtëzuar për mbrojtjen civile”.

14. Projektvendim “Për miratimin e planit të arsimit parauniversitar 2026-2030, bashkia fier”.


15. Projektvendim “Për miratimin e pasqyrave financiare të konsoliduara për vitin 2025 të bashkisë fier dhe institucioneve vartëse”. Dhe...

16. Projektvendim “Për miratimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2025 të shoqërisë apollonia sha”.

Kush është dakord përveç pikës 10, pikat e tjera, përveç pikës 10 që tërhiqet?

Znj.Antoneta Çunaj

Një minutë, një minutë kryetar. Përpara se ta hidhni në votim unë kam një, kam një kundërshtim. Në bazë të VKM-së numër 550 datë 24.12.2023 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për llojin e dokumenteve për procedurën e administrimit, të shfrytëzimit të ndërtesës, mënyrës së pagesës, numrit të ndërtesave, të zyrave vendore dhe për kufijtë maksimalë të qirave për zyrat qendrore dhe vendore të partive politike” në pikën dy të saj thuhet se “partia politike që përmbush kushtet sipas ligjit përkatës të ndryshuar, ka të drejtë të paraqesë kërkesë për pajisjen me ndërtesë pranë dy institucioneve, I pari është ministri I brendshëm dhe I dyti është kryetari I bashkisë”. Fakti që nënkryetari I partisë socialdemokrate Z.Vrioni, pa autorizim, që në fillim, kërkesa është e paligjshme për arsye se është firmosur nga nënkryetari I partisë socialdemokrate Vrioni që realisht duhet të firmoset nga kryetari I psd-së ose të shkruhet në prani të, në prani të autorizimit. E para që do të thotë, e dyta, e dyta, kjo kërkesë është absolutisht e pavlefshme dhe është e paligjshme sepse nuk, nuk na I drejtohet ne si këshill. Dhe për këtë qëllim komisioni që është marrë në shqyrtim, ju që në fillim, ju të gjithë kryesia që çuditërisht për herë të parë ndodh



8

që kryesia firmos akte të cilat ajo duhet t'i pranojë për shqyrtim. Dhe ky është një konflikt i hapur interesi, se nuk ka të drejtë, neni 96 i rregullores së këshillit bashkiak të qytetit të fierit e përcakton në mënyrë taksative se si bëhet kërkesa dhe se kush I bën projektvendimet dhe relacionet. Megjithatë që në fillim kjo kërkesë është e paligjshme për arsye se nuk duhet t'i drejtohet këshillit dhe aty ku keni mbështetur ju VMN nr. 258 datë 20.04.2023 , pika 2, duhet t'i drejtohet kryetarit të bashkisë dhe jo ne. E dyta, çudia më e madhe është se komisioni në kundërshtim me këtë rregullore bën korrigjime. Komisioni nuk ka të drejtë të bëjë korrigjime të akteve procedurale, sepse nuk ka këtë kompetencë. Kompetenca e komisioneve të marrit në shqyrtim akte që venë të protokolluara në këshill ka vetëm të drejtë të shikojë ligjshmërinë apo paligjshmërinë e tyre. Por nuk mund të bëhen dot partues të të akteve të tilla siç është relacioni dhe procesverbali dhe vendimi dhe projektvendimi që do të miratohet në këshilli. Për të gjitha këto që thashë janë një pengesë e rëndësishme dhe dhe për herë të parë ndodh një gjë e tillë që në kundërshtim të hapur me VKM-në kërkohet të futet në shqyrtim në rend dite një akt që nuk është në kompetencën tonë. Këtë e bëj prezent për t'ia bërë sepse të gjitha këto shkruhen në procesverbal dhe shkojnë edhe në prefekturë. Pra kjo pikë e projektvendimit për arsye që thashë që nga momenti i bërjes së kërkesës, që nga momenti i bërjes së akteve që dhe pas andej çudia më e madhe është komisioni i ndryshon. Nuk ka të drejtë të ndryshoj, për këtë kërkoj të hiqet nga rendit i ditës pasi nuk është kompetencë e këshillit për tu marrë me këtë punë, por është e kryetarit të bashkisë.Faleminderit!

Z.Melsi Bogdani

Shumë faleminderit. Shumë faleminderit. Për propozimin hedhim në votë rendin e ditës të lutem.

Znj.Antoneta Çunaj

Jo,jo njëherë do të hedhësh këtë që thashë unë

Znj.Evis Sema


Kryetar të lutem se kam edhe unë një ...

Z.Melsi Bogdani

Po ngrijeni dorën Visa unë nuk pashë të

Znj.Evis Sema

Dua vetëm një sqarim sepse janë gjëra për të cilat votojmë ne. Më gjeni një pikë tek rregullorja në të cilën kryesia e këshillit ka të drejtën të hartojë një projektvendim, ta firmosi vetë , ta bëj propozimin, ta firmosi këtë propozim, ta hedhi këtu në votim. Edhe në fund fare ju që jeni kryesi, do ta votoni përsëri,më dukset se bëni konflikt interesi, do ta çoni në prefekturë, atëherë I bie që kryesia, kryesia vetë harton, vetë firmos, vetë vulos, i çon në prefekturë, i votoni këtu dhe ne këshilltarët s`kemi pse të rrimë pastaj. Unë jam përsëri për këtë projektvendimin e kësaj, të hartuar për pikën 11, jam që të hiqet nga rendi I ditës.



Z.Melsi Bogdani

Kryetarët e grupeve, ndonjë mendim për këtë pjesë nga grupi më i vogël? Të lutem grupi më i vogël, pastaj grupi më i madh. Endri?

Z.Endri Jaupaj

Plotësisht dakord për ta kaluar në votim si anëtarë i kryesisë edhe i ftoj që t'i drejtohen gjykatës administrative për pretendimet e tyre. Këtu është me votë, unë mendoj të vazhdojmë me pjesën e votës, për aq sa kam.

Z.Melsi Bogdani

Niku?

Z.Kreshnik Dapi

Ne si grup socialdemokrat dhe si propozues dhe si firmëtar jemi plotësisht dakord, dhe në qoftë se më lejoni unë mund të ...

Z.Melsi Bogdani

Jo kur të vijë radha e pikës, sqarimet e mëtejshme kur të vijë radha e pikës. Beni?

Znj.Antoneta Çunaj


Me leje?

Z.Melsi Bogdani

Të lutem Neta të lutem. Jo, nuk ka leje, të lutem, një sekondë, një sekondë, të marr dhe mendimin e grupit, të marr dhe mendimin e të gjithë grupit të kryetarëve të grupit, të lutem. Të lutem.

Z.Arben Çuko

Ne jemi plotësisht dakord që të kalojmë në rendin e ditës pikën 11. Nëse meqënëse mu dha fjala mund të vazhdoj edhe në lidhje me atë që tha dhe zoti Hajdaraj, në mbledhjen e kryesisë ne diskutuam për klubin e sportit Apollonia dhe për zotin Kokëdhima. Nëse ka hapësirë ligjore do të ishte e mirë sot në mbledhjen e këshillit e kemi vërë re mungesën e kryetarit, po bëhen disa mbledhje që s'vjen, të jetë i pranishëm, do të ishte mirë të ishte dhe ai këtu sot. Kemi ngritur problematikat edhe më përpara, unë ne kemi kërkuar dhe si grup për ardhjen e zotit Kokëdhima në një interpelancë. Nëse ka hapësira ligjore, zoti Hajdaraj me Antonetën së bashku mund ta shikojmë se në çfarë situatë e çoi Koço Kokëdhima ekipin Apollonia. Nëse mund të gjejmë hapësira ligjore mundet që edhe të hiqet, nuk është ndonjë problem. Ka pasur persona të tjerë, presidentë klubesh të Apollonia që kanë dhënë kontribut të jashtëzakonshëm dhe nuk kanë marrë asgjë, ndërsa zoti Kokëdhima e konsideron si lopë që milet klubin Apollonia dhe e ka katandisur në këtë derexhe. Një nga problematikat e tjera ne kemi meqënëse është dhe sezoni veror,



meqënëse mora fjalën mos të më ndërpritni, është dhe rruga e Semanit. Meqënëse kryetari nuk është në çfarë situatë është edhe punimet në lagjen Mbrostar Ferko si t'i themi ne. Në afrim të ri, është bërë një katastrofë atje. Punimet janë lënë përgjysmë me ç'di unë dhe qytetarët vijnë dhe ankohen. Në Mbrostar Ferko atje janë më shumë se një mijë shtëpi që banohen dhe atje është për të ardhur keq nuk kanë lënë një trotuar. Meqënëse tani ka ardhur dhe që jemi pranë verës, sezonit, ne kemi diskutuar dhe herë të tjera dhe në lidhje me fushën e mbetjeve urbane. Atëherë e quajtmë si histori suksesi sepse do vinin të depozitoheshin mbetjet urbane, tani në çfarë situatë është atje, fusha e mbetjeve urbane atje është bërë një mal i madh me mbeturina. Do ishte në nderin e tij këshillit që jemi ne këtu së bashku, atëherë kur hodha unë mendimin nëse inceneratori që I bëra një pyetje zotit Subashi, ka plan A dhe plan B, se unë dija që inceneratori i Fierit nuk do të vihesh në punë dhe ai qeshi. Tani do të jetë në nderin tonë që ne ta heqim atë, s'kanë pse vijnë të gjashta bashkitë të hedhin mbetjet se s'është qyteti i Fierit kosh plehrash. Mundësisht t'i bëjmë dhe thirrje dhe drejtuesve politike, vota kanë marrë shumë, le t'i na heqin atë fushën e mbetjeve urbane, çdo bashki t'i përpunojë vetë ato mbetjet urbane. Kaq kisha faleminderit.

Z.Melsi Bogdani

Marjus?

Z.Marjus Voja

Ne jemi dakord që kjo pikë e rendit të ditës të futet.

Z.Melsi Bogdani

Për shqetësimet e dy kolegëve dhe të Visës dhe të Netës, në qoftë se baza ligjore nuk është e saktë, ka institucione, ka institucione përkatëse. Ka institucione përkatëse që I kthejnë përgjigje këshillit bashkiak. Kështu që e hedhim në votë rendin e ditës.

Miratimin e rendit të ditës pa pikën 10, kush është dakord?

Atëherë 36 vota pro, një kundër.

Miratohet rendi I ditës.

Pro 36 vota.

Kundra s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Dua të citoj diçka përpara se të filloj me pikën e radhës së rendit të ditës. Kush drejtori përkatëse e ka përgatitur materialin, në momentin që do vijë radha për prezantimin e rendit të ditës, do vijë përpara në podium që të bëjë sqarimet përkatëse. Kush nga drejtorat ose kush nga nënkryetarët e

11

bashkisë. Dakord? Do dalin para mikrofonit për pyetjet që kanë këshilltarët, edhe për derisa të mbarojë pika e tyre.

Shumë faleminderit.

Pika e dytë e rendit të ditës.

Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Këshillit, datë 30.04.2026.

Z.Melsi Bogdani

Sekretar.

Z.Armando Çupa

Procesverbali është dërguar në mënyrë elektronike si zakonisht të gjithë kryetarëve të grupeve dhe kanë ardhur, dhe kanë firmosur pa kundërshtim.

Z.Melsi Bogdani

E hedhim në votë procesverbalin?

Kush është dakord? 37 vota pro. Miratohet. Një abstenim, ndjesë, ndjesë inxhinier. Inxhinieri të kërkoj ndjesë.

Pro 36 vota.

Kundra s`ka.

Abstenim 1 votë.

Miratohet.

Pika e tretë e rendit të ditës.

Projektvendim : "Për dhënieien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin prill 2026"

Z.Melsi Bogdani

Mirela! Në podium.

Znj.Mirela Pitushi

12

Përshëndetje të gjithëve. Për sa i përket pikës së tretë të rendit të ditës është fondi i kushtëzuar 6% që akordohet nga Ministria dhe ekzekutohet në bashkinë e Fierit. Ky fond në këto momente është në shumën 206,565 lekë. Është një fond që nuk ka ndryshime për sa i përket heqjes së ndihmës ekonomike por ka një shtesë, për të ardhur tek pjesa e shumës, janë dy familje 1.Majlinda Lulëzim Omari NjA.Nr.3 dhe 2.Gentiana Aqif Zenunaj Nj.A Cakran. Nëse keni ndonjë gjë për të më pyetur unë jam e gatshme të pres pyetjet tuaja dhe t'u përgjigjem.

Z.Melsi Bogdani

Atëherë, kush nga...?

Z.Ilia Fili

Këto zonjat që përmendët ju janë kryefamiljare?

Z.Melsi Bogdani

Inxhinier, një sekondë të lutem t'i japim fjalën para se të bëni pyetjet, t'i japim fjalën komisionit përkatës nëse është mbledhur, pastaj pyetjet.

Z.Elvi Daka


Përshëndetje të gjithëve. Të nderuar kolegë, pika 3 e rendit të ditës ka të bëjë me dhënien e fondit 6% të ndihmës ekonomike, një procedurë e përmuajshme. E mbështetur në ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, pastaj në ligjin 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë". Në datën 26.05.2026 është mbledhur Komisioni i Mirëqënies Sociale, barazisë gjinore dhe të drejtave të njeriut ku ka shqyrtuar këtë projektvendim. Nga skema e ndihmës ekonomike nuk del asnjë familje për muajin prill, por shtohen dy familje të reja, gra kryefamiljare, të cilat me procedurën dhe me dokumentacionin e paraqitur plotësojnë kushtet e vulnerabilitetit për të qenë le të themi përfituese të kësaj skeme. Kjo është një procedurë që Këshilli Bashkiak e kalon çdo muaj. Jemi në një nivel disi të kontrolluar të ndihmës ekonomike, sepse kemi vetëm 46 familje në bashkinë e Fierit që përfitojnë nga kjo skemë. Që duke e konsideruar me bashki më të vogla nga ne, është një numër relativisht i kontrolluar, inxhinier dhe të gjithë anëtarëve të këshillit. Kështu që vlera totale e të gjithë le të themi përfitimit për 46 familje është 206,565 lekë, siç e citoi edhe nënkryetarja e bashkisë dhe për këtë arsye komisioni ka vendosur ta kalojë për miratim në këshill këtë projektvendim të paraqitur nga bashkia Fier. Faleminderit.

Z.Melsi Bogdani

Pyetje nga këshilltarët? Diskutime? E hedhim në votë. Kush është dakord? 37 vota pro. Kundër? Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Pro 37 vota.

Kundra s`ka.



Abstenim s'ka.

Miratohet.

Z.Gëzim Hajdëraj

Për procedurë.

Z.Melsi Bogdani

Po.

Z.Gëzim Hajdëraj

Mendoj që ju realisht nuk keni pse ja jepni fjalën përfaqësuesve të administratës, nënkryetarëve, ne i kemi materialet. Duhet të flasi vetëm përfaqësuesi i komisionit përkatës. dhe në qoftë se ka pyetje atëherë vazhdojmë ne i bëjmë pyetje atyre, sepse ata i kanë bërë parashtrimet kur kanë paraqitur materialet në këshill, prandaj mendoj që duhet t veprohet n këtë mënyrë. Materialet,kërkesat e bashkisë kanë argumentat përkatëse , komisioni përkatës ka argumentat e tij të parashtruarau, anëtarët e këshillit i dëgjojnë të dyja këto dhe kalojmë direkt në votim.

Z.Melsi Bogdani

Shumë faleminderit, por nuk do lexohet i gjithë relacioni nga ekzekutivi. Thjesht do dalin këtu për të dhënë dy, tre shpjegime dhe në qoftë se ka pyetje të përgjigjen shkurtimisht...

Z.Gëzim Hajdëraj

Shpjegimet ata i japin në materialet përkatëse. Nuk ka nevojë të përsërisim materialet Nqs në materialet përkatëse nuk janë dhënë shpjegimet e duhura atëherë le ti bëjnë më mirë ato matriale dhe t'ia paraqesin anëtarëve të këshillit.Materialet janë për secalin anëtarë të këshillit, t'i studiojnë , t'i bëjnë. Kush ka pyetje bën pyetje. Nuk është nevoja të përsërisim leximin e materialeve


Z.Melsi Bogdani

Shumë faleminderit... Ok.

Pika e katërt e rendit të ditës.

Paraqitja nga Këshilltarët e Çështjeve dhe Problematikave të Komunitetit

Z.Melsi Bogdani



Në këtë pikë dua të citoj, koha për secilin këshilltar do jetë dy minuta. Zgjatja e kësaj pike në kohë do jetë rreth 30 minuta. Dhe problematikat në qoftë se ekzekutivi do të ketë mundësinë t'i kthejë përgjigje këshilltarit në këtë moment, ndryshe do mbahen shënim dhe në mbledhjen e radhës do kthehen përgjigjet përkatëse.

Kush e do fjalën?

Po


Z.Besnik Brahimaj

Tani gjatë gjithë kohës kemi ngritur probleme por asnjëri se ka patur terezinë dhe nuk e ka vënë ujën në zjarr për zgjidhjen e tyre sidomos për çështje që kanë të bëjnë me interesin e qytetarëve. Kemi ngritur disa herë problematikat e lagjes 1 Maj ku shtrihet territori i spitalit problem të cilin unë personalisht e kam ngritur shpeshherë dhe nuk ka gjetur rrugëzgjdhje deri tani, ka rreth gjashtë muaj që materniteti i qyteteit të Fierit ka kaluar nga qendra spitalore në në lagjen 1 Maji, që rrugët e kësaj lagjeje janë duke u riparuar akoma , po dhe ato rrugë që janë të përfunduara... po të kaloni... rrugën Naun Kaçaku në mëngjes... bllokohet komplet rruga sepse në të dyja anët e rrugës parkojnë makina edhe pse është me dy kalime ka vetëm një rrugë për të kaluar, Tek shkolla në lagjen "1 Maj", tek shkolla "Flatrat e Dijes" aty ka vetëm një rrugë ku ambulanca nuk kalon dot , të sëmuret nuk kalojnë dot edhe pse është një institucion i rëndësishëm së veçantë materniteti i Fierit nuk ka një tabelë. E kam ngritur disa herë për një pikë orjentuese, duhet tabelë, por në lagjen 1 Maj nuk është vënë asnjë gjë Ka pjesë rrugësh që janë të prishura dhe para materialitetit kur është hapur vitin e parë që ka kaluar materniteti në atë godinë ... Kryetari ka ardhur, i ka parë vetë kryetari i Bashkisë u hoqën plehrat u hodhën një akull aty, u çua dhe tabela , që tani janë zënë dhe janë bërë prona private dhe jepet me qira.Nqs është e tillë Bashkia t'i marrë me qira, dhe të na i japi sepse s'kemi ku parkojnë makinat, kur vijnë qytetarët. Sepse ca i zënë qytetarët që kanë të tregjet aty, zënë rrugën, nuk hyjmë dot në maternitet e nuk del dot.

Janë ca mure të vjetra që ne si prekim dot se nuk janë të tonat, janë në anë të rrugës që kanë ferra dhe janë kthyer dhe në tualete për qytetarët që kalojnë rrugës sepse ashtu është kther ambjenti dhe asnjë nga drejtorët e rrugëve nuk ka ardhur, policia bashkiake që ti shikoi. Nënkryetarët e bashkisë të vijnë ti shikojnë që të merren masa ...

Aty lind jeta,aty vijnë vetëm gra të shoqëruar nga bashkëshortët e tyre. Vallaj të kalojë një grua në mes të ferrave, në mes të mureve të rëna, në mes të papastërtive dhe pislleqeve mua po më duket e habitëshme tani kohët e fundit. E kam ngritur disa herë këtë problem z.kryetar por nik ka gjetir zgjidhje. Ka dhe rrugë të tjera ka dhe vënde të tjera, janë ca qendra të vogla sociale në lagjen Kongresi I Përmetit. Është një qëndër një pallat aty tek Vrenozët, ku aty janë disa qendra për këta fëmijët me AKRRuga që është aty nuk është as 50 m, nuk e shikon asnjëri që është prishur, bien fëmijët dhe vriten, goditen, rripen nga ajo pjesë që e ka grryer edhe uji dhe dy rrugë të vogla anash.Duhen patur në vëmendje sepse bashkia po bën rrugë dhe ka lënë këto gjëra të vogla pas dore.Faleminderit!

Znj.Brunilda Hoxha



Me leje?

Z.Melsi Bogdani

Po, Gëzim, Bruna pastaj ju.

Znj. Brunilda Hoxha

Përsëritet të gjithëve. zonja dhe zotërinj të nderuar! Kam shumë shkurt disa pyetje të cilat unë i kam bërë në mbledhjet e kaluara... afërsisht po vjen viti... dhe nuk është dhënë ndonjë përgjigje.

Thjesht dua të di, nëse do të ketë përgjigje në një kohë të caktuar.

E para ka qenë, krijimi i një qendre kulturore për pensionistët e qytetit të Fierit. Dhe sa e mundshme është kjo të realizohet, unë mendoj se, po ta shikojë bashkia edhe me një çikë dashamirësi, mendoj që kjo mund të realizohet dhe do të jetë një sukses shumë i madh për qytetin e Fierit... por mendoj se dhe në rang Republike.

Pyetja e dytë që kam qenë, që kam bërë... çfarë u bë për Led-Wall-in e Teatrit të Fierit. Nuk kam marrë përgjigje.

Dhe pyetja tjetër është... kemi diskutuar këtu në këshill për sa i përket ditës së parë, të hapjes së shkollës shqipe në qytetin e Fierit. Ishte një datë që e diskutuam të gjithë, dhe ramë dakord që të mbledhet një komision, të krijojë ato mundësitë e mundshme për të marrë të dhënat në institucionet përkatëse, dhe të dalim në një konkluzion që qytetit të Fierit t'i vihet një datë e hapjes së shkollës së parë shqipe.

Këto kisha, faleminderit!

Z.Melsi Bogdani

Kush e do fjalën? Po Gëzim.

Z.Gëzim Hajdëraj

Siç thashë dhe në fillim që bashkia duhet të marrë në analizë urgjente faktin e klubit të futbollit. Rënia nga kategoria e dytë në të tretën është skandaloze dhe bashkia duhet të bëjë një analizë të detajuar dhe të marrë masat përkatëse për përmirësimin e kësaj gjendje. Patjetër duhet të ketë përgjegjësi për drejtuesin e klubit të futbollit. Problemi i dytë që ngrita ka të bëjë me nisjen e sezonit veror dhe sidomos me planet për rrugët që të çojnë drejt bregdetit të cilat vazhdojnë të jenë në gjendje skandaloze. Unë e kam thënë vazhdimisht që bashkia e Fierit është bashkia më e dobët në Republikë për sa i përket të gjitha rrugëve komunikuese me bregdetin. Ne jemi e vetmja bashki që ne nuk kemi as kushtet e Fierit të 1960, kur Semani ishte një qytezë e tërë, ata që janë në moshën time e dinë këtë gjë. Problematika e tretë. E kam thënë dhe më parë sidomos tani që jemi në fillim të sezonit veror dhe trafiku rritet, është vendosja e semaforëve. Nuk mund të vazhdojë më kjo gjendje, patjetër që duhet bërë një ndërhyrje urgjente për vendosjen e semaforëve. Problemi tjetër lidhet me pallatin e sportit. Ne jemi i vetmi qytet i rëndësishëm në Shqipëri që nuk kemi Pallat Sporti. E kam ngritur vazhdimisht dhe përsëri vazhdon e njëjta

gjendje. Nuk kemi pse ne si qytet, që kemi qënë ndër të parët në Shqipëri, të katandisemi pa Pallat Sporti, nuk them se për këtë gjë fajin e ka vetëm bashkia por sidoqoftë duhet të bëjmë përpjekjet maksimale si nga ana administrative dhe nga ana financiare për ta zgjidhur këtë problem. Këto ishin pak a shumë problematikat që kisha për të ngritur.

Znj. Antoneta Çunaj

Me leje, kryetar?

Z. Melsi Bogdani

Po Neta!

Znj. Antoneta Çunaj

Zoti kryetar, marr shkas nga vendimi numër 5, datë 10.05.2016, dhe nga prezantimi juaj si anëtar i kryesisë, për këshilltarin Endri Jaupaj. Endri Jaupaj ka hyrë në kryesinë e këtij këshilli nga..."

Z. Endri Jaupaj

Dole nga rendi i ditës, nuk je më kryetare, të lutem mos prish mbarrëvajtjen e mbledhjes.

Z. Melsi Bogdani

Endri të lutem fike pak mikrofonin. Të lutem, të lutem. ish Kryetare, jemi në pikën...

Znj. Antoneta Çunaj


Tek diskutimet

Z. Melsi Bogdani

Nuk janë diskutime. Thotë pika 'Paraqitja nga këshilltarët e çështjeve dhe problematikave të komunitetit'. Kjo është problematike e Këshillit. Kur të mbarojë pika e rendit të ditës, ngrije si shqetësim.

Znj. Antoneta Çunaj

Edhe kjo problematikë është, është problematikë e jona. Cili është statusi i Endri Jaupajt që merr pjesë në kryesinë e këtij këshilli? Pasi në momentin që ka hyrë Endri Jaupaj në këtë këshill, ka qenë subjekt i partisë politike Partia Demokratike me Lulzim Bashën. Partia Demokratike me kryetar Lulzim Bashën me vendim gjyqësor të formës së prerë të apelit Tiranë është shfuqizuar. Aktualisht, këshilltari Endri Jaupaj ka mbetur pa subjekt politik." Gjithashtu Gjatë kësaj kohe kanë ndodhur disa ndryshime: Shqipe Morina ka hequr dorë dhe ka kërkuar të bëhet pjesë e



Partisë Socialiste. Mësuesja Suzana Numani, kam parë listën e këshilltarëve të Fierit tani, është futur te Partia Demokratike me kryetar Sali Berishën dhe përzgjedhja e Endri Jaupit është bërë me këta dy persona, plus edhe Besnikun. Dhe po them që Endri Jaupaj është njësoj si unë dhe të gjithë këta këshilltarët e tjerë ose këtu personalisht përpara të gjithë gazetarëve të na japi statusin politik dhe kush është grupi që përfaqëson Endri dhe të tjerët ndryshe është një shkelje e hapur që futet në institucione, një person që nuk ka tagra për t'u futur në kryesinë e këshillit. Kjo gjë përbën vepër penale e parashokon neni 224 i Kodit Penal, kryerja e funksionit pas dhënies fund. Ai I ka dhënë fund këtij mandati dhe ai duhet të dali siç dola dhe unë nga kryesia mbas mbarimit të mandatit si anëtare e kryesisë.

Z.Melsi Bogdani

Shumë faleminderit. Pika 4 ka të bëjë me pyetje nga këshilltarët për ekzekutivin. Këtë përgjigje nuk ua jep dot ekzekutivi, kështu që kalojmë... kush e do fjalën? Po, Erlinda.

Znj.Erlinda Llupi

Përshëndetje të gjithëve. Për shkak të kohës së kufizuar po theksoj disa problematika. E para lidhet me lagjen '1 Maji', ku çdo të diel zhvillohet tregu i frutave perime dhe pas kësaj nuk vijnë të pastrojnë. Por vetëm në darkë në mbrëmje mblidhen koshat. Ky është një shqetësim shumë i madh për banorët e lagjes 1 Maj dhe kërkon zgjidhje të menjëherëshme.

Problemi i dytë është siguria rrugore te kthesa e kryqëzimit të Grecallisë. Ky segment është kther në një pikë të zezë ku pothuajse çdo muaj ndodhin aksidente. Mungesa e plotë e sinjalistikës orjentuese dhe mungesa e ndriçimit dhe mungesa e rregullatorëve të shpejtësisë, bëjnë që drejtuesit e mjeteve të kalojnë në këtë kryqëzim pa respektuar përparësinë duke e kthyer këtë kryqëzim në një rrezik permanent Kërkoj që të instalohen semaforët dhe policët e shtrirë. Faleminderit.

Z.Melsi Bogdani

Kush e do fjalën? Po, Niku.

Z.Kreshnik Dapi

Përshëndetje të gjithëve!. Dua ta filloj me një problematikë që shqetëson komunitetin tonë këtu, mqs është edhe kryetari i bashkisë këtu, kemi një problem të madh me zyrën e protokoll arkivës. Shumë letra dhe kërkesat sidomos nga qytetarët por edhe nga subjekte të tjera në drejtim të këshillit bashkiak jo vetëm që nuk vijnë por me sa kuptojmë ka dhe devijim të destinacionit . Duam që kjo praktikë ose ky handicap të marrë fund sepse është edhe një vepër e dënueshme me ligj. E dyta, dua të shpreh shqetësimin e banorëve të lagjes Apollonia; në atë bllokun e pallateve pas ish-MAPO-s ushqimore... aty është një territor që ne e kemi miratuar në dhjetor të 2024 për

18

t'u shtruar si shesh dhe akoma deri më sot ai shesh nuk është shtruar. Është në një gjendje shumë të keqe.

Tjetra është një ankesë e banorëve të lagjes Malaj' në fshatin Kreshpan, për rrugën lidhëse të lagjes së tyre me rrugën nacionale; është e pashtuar dhe në gjendje shumë të keqe dhe pa ndriçim natën. Po ashtu, një shqetësim të banorëve tek pallati në qendër pranë Kishës Ortodokse, për sheshin që ndodhet pas atij pallati, gjithashtu në një gjendje shumë të keqe. Edhe shqetësimin e banorëve të fshatit Kreshpan për sheshin përpara xhamisë në qendër të fshatit, po ashtu dhe ai është në gjendje skandaloze. Faleminderit."

Z.Melsi Bogdani

Kush e do fjalën? Po, Visa.

Znj.Evis Sema

Të rishikohet edhe njëherë kjo praktika që ju e keni futur si pikë të katërt të rendit të ditës: 'Paraqitja nga këshilltarët e çështjeve dhe problematikave të komunitetit'. Mua deri në këto momente mu duk vetja si në një dëgjese publike dhe jo sikur jam në një mbledhje këshilli.

Z.Melsi Bogdani

Do ta shikojmë atë, Visa. Po, ne së bashku kemi miratuar Rregulloren, dhe kemi ngritur kartonin dhe e kemi kaluar në këtë këshill rregulloren e këshillit bashkiak.

Znj.Evis Sema

Kemi gati një orë e ca në mbledhje dhe ne skemi mbyllur akoma diskutimet.

Z.Melsi Bogdani

.Rendi i Ditës i është përshtatur Rregullores...

Znj.Evis Sema

Thashë të shikohet pak dhe kjo pika të vendoset diku tjetër dhe jo në fillim të rendit të ditës, se u bë si dëgjese publike.

Z.Melsi Bogdani

Shumë faleminderit. Doktoreshë Anisa, të lutem

Znj.Antoneta Çunaj



Më fal zoti kryetar,por duhet të vijmë me emra konkretë këtu, jo siç foli koleku që ne në përgjithësi nuk na vijnë aktet, jo të vijmë këtu pa u përgatitur. Kush akt, kush akt? Kush akt nuk është lejuar nga PSD-ja të vijë në këshill? Me emra jo kështu.Nuk e zgjidhim dot kështu se kështu do të rrimë tërë natën. Nuk bëhet kështu mbledhja. Të vijë konkretisht.

Z.Melsi Bogdani

O Neta, e ka fjalën Anisa, të lutem...

Znj.Anisa Pllaha

Përshëndetje të gjithëve! Çështja e komunitetit nga njerëzit ku unë jetoj dhe takoj përditë, është gjendja e rrugës së lagjes 'Afrim'. Ata janë të paqartë se kur do mbyllet. Janë duke u bërë disa meremetime të vogla të cilat edhe ato mendoj që duhet të mbikqyren, ndërkohë që është rruga kryesore ,gjendja e kanaleve. Çfarë po bëhet? Se aty është komplet kanalizimi mendoj që ato kanalet anësore duhet të mbyllen sepse janë burim infeksioni nga ujërat, mushkonjat etje E dyta, aty është dhe një ambjent që është dhënë me qera për mjetet e bashkisë Fier, mbase jam e gabuar, janë duke u kthyer në shqetësim për komunitetin, kalojnë mjete të tonazhit të rëndë, sjellin materiale inerte , bëjnë zhurmë, pluhur.. nuk di si do të organizohet puna aty që të mos bezdisen dhe shqetësohen edhe njerëzit që jetojnë aty.

Z.Melsi Bogdani

Shumë faleminderit. Po Gone!

Z.Agron Profka

Është një problem në lagjen 15 tetori, rruga Arrilla Bozdo, ka këtu e 3 muaj që e kam bërë problem, bashkë me kryetarin e rajonit, kam vajtur edhe tek ujësjellësi, më është premtuar. Është hapur një gropë, unë tre herë e kam mbyllur me beton ajo tre herë është hapur, nuk kam çfarë t'i bëj ndryshe. Problemi im kryesor është se ajo është rrafsh me kolektorin kryesor të qytetit. Dhe po u çu ai kolektori i qytetit, ajo do ketë pasoja të mëdha pastaj. Nuk po vihet dorë fare. Dhe një mendim që më erdhi nga ujësjellës kanalizimeve, ishte që t'i vinim një kapak metalik. Ai kur grryret nga poshtë si mund t'i vihet kapak metalik? Kush do ma shpjegojë këtë kaq kisha? Ajo do një ndërhyrje urgjente, për mendimin tim.

Z.Melsi Bogdani

Shumë faleminderit, inxhinier.

20

Z.Illia Fili

Mqs kemi kryetarin sot, unë e kam shtruar disa herë, por së pari ne kemi bërë një park të bukur në qëndër, ku zakonisht mbasditeve ku zakonisht si banor i lagjes mqs banjo aty pranë shikoj që qytetarët e vlerësojnë atë park, ai park ka shumë gjelbërim sidomos tani gjatë pranverë- verës, por nuk shoh mirëmbajta të atij parku, çfarë sugjerojë?. Në çdo pemë të mbjellë në atë park, ka të shtuar linjë elektrike për llampë ndriçimi, dhe asnjë llampë nuk funksionon. As tek pedonalja, as tek parku qëndror.

Tjetër, kemi investuar goxha mirë për disa shatërvane në qytet, e kam ngritur dhe disa herë të tjera dhe shatërvanet nuk funksionojnë. Por për ironi të fatit, në ditën që Fieri nuk kishte ujë, shatërvani i madh i parkut punonte! Sikurse na i bëne për zili:Ju nuk keni ujë unë kam!Të nesërmen kur erdhi uji shatërvani nuk punonte. Njëkohësisht... kolegët e mi që besojnë tek feja myslimane mund ta kenë vënë re që para xhamisë janë nja 9 shatërvane të vegjël, kanë qënë shumë të bukur kur ata funksiononin. Tani ata e kanë ndërprerë funksionin. Unë e thashë edhe radhën e kaluar por po e përsërisë edhe tani. Ato duken si arkivole përpara xhamisë. Duhet urgjentisht të vihet dorë në to.Së fundi unë kam dhe një pyetje , dua të më mirëkuptoni, klasa jonë politike do të punojë dhe do të luftojë që në organet tona që janë zgjedhur në qytet dhe do të zgjidhen ka dhe do të ketë përfaqësues nga emigracioni, dhe është detyrë që ata të marrin pjesë në jetën tonë politike, të marrin pjesë në organet tona që i kemi zgjedhur. Lind pyetja:A ka ndonjë vendim zoti kryetar që këta persona që ne i ftojmë të na marrin pjesë, apo për vendimmarrje, tu mbulohen shpenzimet që ata të vijjnë këtu dhe të qëndrojnë këtu, siç kanë deputetët të drejtë që shkojnë në shërbime me dieta, pagesë udhëtimi, karburant.Po për anëtarët e këshillit, tek ne apo të vlorës, sepse dhe në Vlorë kishte nga emigracioni, ka ndonjë vendim që shpenzimet e tyre të udhëtimit të përballohen nga bashkitë?

Znj.Elida Sopot

Nëse bëhet fjalë për mua, unë vij me shpenzimet e mija.

Znj.Brunilda Hoxha

Jo, jo Lida nuk ka të bëjë me ty por ka të bëjë me faktin që kur ishin ne në vlorë një pjesë e këshillit,dhe e ka konkretisht me këtë ngjarje nuk e ka me ty.

Znj.Elida Sopot

Më duket se foli për emigracionin.Unë jam këshilltare dhe përfaqësoj diasporën e Fierakëve në Greqi. Unë vij me shpenzimet e mia. Juve që vini nga Shqipëria merrni të njëjtat lekë me mua, dhe unë këtë radhë dhe çdo herë tjetër që kam ardhur kam ardhur me shpenzimet e mia dhe nuk i përballoj dot me thënë të drejtën se siç e keni parë unë vijë shpesh, nuk jam nga ato që rri e të pres...Tani nqs mendoni se është e drejtë kjo....të paguaj 150 euro biletën siç e pagova kësaj radhe...

Z.Melsi Bogdani

Kush e do fjalën tjetër që ta mbyllim këtë pikë? Mësuese? Po. Po Yllka

Znj.Yllka Sheshi

Shumë herë e kam ngritur një problematikë që është shqetësuese që është në lagjen 1 Maj që është pas kopshtit "Markelino". Jemi në vitin 2026, aty janë banues të paktën nga 94-a dhe më bie shpesh rruga që vete dhe sa herë vete më thonë :Çfarë do bëhet në lagjen tonë për ujërat e zeza? Mirë... ujërat e bardha e kanë gjetur vetë se për t'ë pirë ujë, kanë ndërtuar ato pusët e tyre. Nuk është normale, janë shumë afër qendrës së Fierit, por shumë larg standardeve të banorëve të Fierit. Kjo është një.

E dyta, nga stadiumi, ose më saktë pallati i verdhë, për të shkuar te Qtu-ja, janë rregulluar disa gropa që ishin, por aty është një grop që, nëse je në errësirë, makinën e ke 100% të dëmtuar sepse është aq e madhe ajo sa po ra goma e makinës... nuk e di se sa herë mund të mallkojnë njerëzit që mund të ngecin aty. Nuk e kuptoj dot kur është bërë rruga, pse ajo më pas, ka vajtur në atë gjendje më pas? Që do të thotë s'është bërë punimi i duhur. Duhet, sepse me të vërtetë ajo është e ngjitur me trotuarin, ajo gropë... po që në momentin që dy makina janë paralel... do apo s'do, makina që ndodhet në krahun e trotuarit do bjerë patjetër aty. Bëni mirë që ta rregulloni, për mos t'u prishur më, sepse disa herë është rregulluar dhe përsëri disa herë ajo prishur...

Z.Armando Subashi

Zyshe nuk është pjesë e bashkisë, e ka ujësjellësi, është për shkak të kanalizimit të ujërave të zeza, ata duhet ta hapin ta rregullojnë...

Znj.Yllka Sheshi

po transmetoj shqetësimin, t'i transmetohet ujësjellësit, ta rregullojë sepse nuk është normale kështu.

Z.Armando Subashi

U mbaj shënim dhe do t'ja përcjellim ujësjellësit, patjetër.

Z.Melsi Bogdani

Atëherë e mbyllim me këtë pikën 4? Po Endri.

Z.Endri Jaupaj

Semaforët e qytetit të Vlorës i pashë që nga moment që u bë gati pjesa e infrastrukturës. Për një muaj sot janë vendosur dhe janë aktivë. Ne kemi kaluar në Këshillin Bashkiak, mendoj që ka kaluar 1 vit, dhe akoma nuk dihet se kur do të vendosen. Një gjë kjo, edhe një tjetër që kam

kërkuar që në fillim, që ditën e parë që jam futur si anëtar i këshillit: këndin e lojërave për fëmijë. Asnjë nga këto, përveç mijëra pikave të tjera... unë e shikoj këtë bashki të dështuar. Unë ia kam kërkuar me shumë dashamirësi kryetarit t'i japë dorëheqjen sepse nuk e ka menaxhuar. Si pasojë e të gjitha atyre që folën të gjithë, po shikoj një qytet domethënë që e ka humbur funksionin e tij nga menaxhimi i kësaj bashkie. Ja kërkova miqësisht, domethënë të japë dorëheqjen, edhe po ia kërkoj edhe prapë tani. Të lutem jep dorëheqjen, t'i vijë dikush tjetër që t'i bëjë këto punë sepse ky qytet ka mbaruar. Kaq kisha.

Z.Melsi Bogdani

Elvi i fundit dhe e mbyllim këtë pikë."

Z.Elvi Daka

Shumë faleminderit kryetar. Shkurtimisht tre gjëra kam që vijnë jo vetëm si problematikë e komunitetit, por një shqetësim i vazhdueshëm për të gjithë ne. E para është rruga rreth Libofshës. Libofsha është një rrugë që është relativisht shumë e ngushtë. Po thuajse e pakalueshme për shkëmbimin e dy makinave. Është bërë një ndërhyrje para një jave, por do të vlerësoja më shumë një monitorim ndaj ndërhyrjes që është bërë, sepse ka lënë vend për të dëshiruar...gjithçka që është bërë për një investim në kohë, në vlerë monetare, në mbushjen e atyre gropave... por brenda një jave aty është bërë prapë me gropa të tjetër, se gjithë ai çakull, a nuk është ngjeshur mirë apo çfarë ka ndodhur, vlen për ta parë monitoruesit e kësaj gjëje.

E dyta, ashtu siç disa prej njësive administrative të bashkisë Fier, edhe ne andej nga Libofsha e kemi një dalje në det. E kemi ëndërr këtu e 30 e ca vite që kam unë të ikim njëherë ti hipim makinës të shkojmë në plazh. Ndoshta, me pak shtysë nga ana jonë, me pak shtysë nga bashkia, nga institucionet e tjera, t'i japim një vëmendje më shumë, duke qenë se Darëzeza dhe Semani po marrin rrugën e tyre... Të kthejmë vëmendjen edhe nga bregdeti i Libofshës, sepse është një vijë bregdetare shumë e pastër, jo vetëm me bregdet, por edhe me resurse të tjera.

E treta që kisha, është... ne në Fier kemi një qendër sociale që quhet 'Murialdo', dhe është djepi, le të themi, i arsimit që në fillimet e demokracisë në qytet. Por aty hyjnë fëmijë, të rinj, dhe nuk kemi një vijë të bardhë tek rruga kryesore, që kur kalojnë rrugën fëmijët, të paktën ta kalojnë të sigurt. Kështu që do të kërkoja vëmendjen e bashkisë që të paktën me ato pengesat ose me ndonjë vijë të bardhë në këto institucionet arsimore sepse kemi parë pjesën e qytetit, po të shikojmë pak edhe pjesën e unazës së jashtme ku ka institucione që ofrojnë shërbime për fëmijët e komunitetit Fierak. Faleminderit!

Z.Melsi Bogdani

Shumë faleminderit. E fundit, po.

Znj.Elida Dhima

23

Përshëndetje. Siç dihet, Pojani ka qenë në projektin e '100 Fshatrave'. Rruga që përshkon fshatin është tepër e ngushtë, nuk ka për të kaluar dy mjete, sidomos tani që është sezoni i turizmit. Vijnë furgonë, autobusë, vizitorë nga vendi, është e pamundur. Kam parë dhe aksidente të vogla që ata i kanë zgjidhur vetë me njëri-tjetrin, por jam përpjekur... makina me njëra-tjetrën janë gërvishtur, kanë thyer pasqyra. Ata e kanë gjetur vetë me njëri-tjetrin të paktën, por që është e pakalueshme.

Dhe kanali anësor i kësaj rruge, që nga dita që është bërë, nuk ka funksionuar për rrjedhjen e tij, se ku është. ajo e meta aty?. Ata thonë: 'Është një kanal tjetër që derdhet', por ku derdhet, s'ë di. Fle uji aty dhe është bërë problematikë për sëmundje. Ne e kemi ngritur dhe herë të tjera, por nuk është zgjidhur ended he me këta të shëndetësisë.

Dhe tjetra, rruga që të çon për në Apolloni është një rrugë e gjerë, por është zënë nga dherat e kanalit, jo nga dhera të thjeshtë që hidhen. Ajo do një pastrim. Aty mund të bëhet edhe një tip parku i vogël që të paktën turistët të ulen të pinë një gjë të ftohtë . Kështu që po u mor parasys, kjo është shumë e mirë. Edhe rruga e Kryegjatës, Të hidhet një shtresë rëre se, një shi të bjerë, e merr çakullin që hidhet, e kështu ajo prishet prapë, dhe të bëjë të mundur që të paktën ambulanca të vejë.

Z.Melsi Bogdani

Shumë faleminderit. Shqetësimet u mbajtën shënim. E mbyllim dhe pikën katër të rendit të ditës në mbledhjen e ardhshme, për të gjitha shqetësimet ekzekutivi do të ketë përgjigjet për Këshillin. Kalojmë në pikën pesë të rendit të ditës:

Pika e pestë e rendit të ditës.


Projektvendim :“Për dhënien e ndihmës shtetërore financiare të shtetases Lindita Lako Lagja Afrim i Ri, njësia administrative nr. 4, dëmtuar nga zjarri i datës 24.04.2026. “

Z.Melsi Bogdani

Nustret? Po.

Z.Nustret Avdullai

Përshëndetje të nderuar këshilltarë! Projektvendimi për vlerësimin dhe dhënien e ndihmës financiare të familjes së shtetases Lindita Lako, Lagja Afrim i Ri, njësia administrative nr. 4, për dëmet e shkaktuara nga zjarri më datë 24.04.2026. Ky vlerësim është bazuar në kërkesën për dhënie të ndihmës financiare për shkak të dëmit të zjarrit në shtëpinë e saj. Kemi marrë informacionin, komisioni është mbledhur dhe ka përcaktuar të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore.Në zbatim të shkronjës b,pika 1, paragrafi 3 të VKM-së nr 329 datë 16.05.2012 u



grumbullua i gjithë dokumentacioni ligjor për dhënien e ndihmës financiare, u mbledhën kërkesat, u ndoqën procedurat dhe komisioni ka përcaktuar dhënien e ndihmës në vlerën 116214 lekë. Ju ftoj ta votoni.

Z.Melsi Bogdani

Shumë faleminderit. Komisioni është mbledhur?

Po, komisioni është mbledhur në prezencë të këshilltarëve Kreshnik Dapi, Marjus Voja, Endri Jaupaj dhe Rrapi Gjika .Ka shqyrtuar me kujdes të gjithë materialin e paraqitur nga ekzekutivi dhe i propozon Këshillit miratimin e tij.

Z.Melsi Bogdani

Ka ndonjë pyetje? Jo. Diskutim s`ka. Hedhim në votë. Kush është dakord? Kundra s`ka. Abstenim s`ka. Miratohet.

Pro 37 vota.

Kundra s`ka.

Abstenim s`ka.

Miratohet.

Kalojmë në pikën gjashtë të rendit të ditës

Pika e gjashtë e rendit të ditës.

Projektvendim "Për miratimin e pagesës së shpenzimeve të varrimit të ndjerës Hava Alushi"

Z.Melsi Bogdani

Nuk kemi çfarë të diskutojmë këtu. Kalojmë në votim. Kush është dakord? Të gjithë dakord.

Pro 37 vota.

Kundra s`ka.

Abstenim s`ka.

Miratohet.

Pika e shtatë e rendit të ditës.

Projektvendim : "Për pranimin në shtëpinë e të moshuarve të z.Rrapo Pashaj"

Z.Melsi Bogdani

"Kush është dakord? Të gjithë dakord. Miratohet.

Pro 37 vota.

Kundra s`ka.

Abstenim s`ka.

Miratohet.

Pika e tetë e rendit të ditës.

Projektvendim:" Për miratimin e përfundimit të procedurave të apartamentit për familjen e shtetasit Todit Silli Llagoni".

Z.Melsi Bogdani

Kush është dakord për këtë? Miratohet.

Pro 37 vota.

Kundra s`ka.

Abstenim s`ka.

Miratohet.

Pika e nëntë e rendit të ditës.

Projektvendim : "Për dhënien e miratimit të ekzekutivit të Bashkisë për fillimin e procedurave të prishjes së objektit shkolla e vjetër 9 vjeçare " Lili Stavre",Topojë.

Z.Melsi Bogdani

Po Niko!

Z.Niko Neço

Të nderuar këshilltarë! Në lidhje me pikën 9-të të rendit të ditës...ashtu siç është parashtruar dhe në relacion e në materialin që i është vënë në dispozicion të gjithë këshilltarëve, bëhet fjalë për shkollën e vjetër Lili Stavre në njësinë administrative Topojë, e cila është një godinë 729 m² në inventarin e bashkisë Fier e ndërtuar në vitin 1961... Duhet të theksojmë se në periudhën 2007-2008, në këtë territor të kësaj shkolle është miratuar dhe është ndërtuar shkolla e re Lili Stavre, për këtë njësi administrative. Si rrjedhojë, godinës së vjetër i ka humbur funksioni i saj. Edhe në aspektin teknik, në normën e amortizimit mund të themi të njëjtën gjë. Megjithatë, nga ana

ekzekutive, nga ana e kryetarit të bashkisë është ngritur dhe grupi i punës për vlerësimin në terren. Sipas procedurave ligjore për nxjerrjen jashtë ërdorimit të kësaj shkollegrupi I punës I cili paraqitur relacionin e tij që është dhe pjesë e dokumentacionit, të serviturur këshilltarëve. Ky grup pune ka konstatuar që objekti është amortizuar dhe ka humbur të gjitha vlerat funksionale. Gjithashtu pjesë e materialit është edhe shkresa e QEA-së dhe kërkesa e Nj.A Topojë për rreziqet që ajo mbart dhe nevojën emergjente që kundrejt gjithë procedurave për tu dhënë miratimi juaj për prishjen e kësaj godine dhe për ta kthyer atë vend në një vend funksional për shkollën e re dhe në këtë rast po bëhen të gjitha procedurat e nevojshme financiare për nxjerrjen jashtë përdorimit të kësaj pasurie publike"

Z.Melsi Bogdani

Shumë faleminderit. Ka ndonjë merak nga këshilltarët? Hedhim në votë. Kush është dakord? Të gjithë pro. Miratohet.

Pro 37 vota.

Kundra s`ka.

Abstenim s`ka.

Miratohet.

Pika e dhjetë e rendit të ditës.

Projektvendim " Per disa shtesa dhe ndryshime në V.K.B Nr.109 datë 27.11.2025 " Mbi struklurçn dhe niveline taksave dhe tarifave vendore të Bashkist Fier për vitin 2026" |

Z.Melsi Bogdani

Pika 10 është tërhequr, për shkak të pritjes së mendimit nga kryetari.

Kalojmë në pikën 11


Pika e njëmbëdhjetë e rendit të ditës.

Projektvendim: "Per shyrtimin dhe miratimin e kërkesës për pajisjen me zyre vendore të Partisë Sociladennokrate të Shqipëris"

Z.Melsi Bogdani

Niku, meqenëse je pjesë e propozimit na jep relacionin përkatës

Z.Kreshnik Dapi



Si pjesë e propozuesve dhe në respekt të transparencës dhe ta marrim edhe si kthim përgjigje për kolegen znj. Antoneta, që e theksoi në fillim të mbledhjes. Unë dua t'ju bëj me dije ju si këshilltarë dhe publikut, dhe me lejen e kryetarit të Këshillit një letër këmbim dhe një kthim përgjigje që kryetari i këshillit po në konsultim me kryesinë e Këshillit dhe grupin e këshilltarëve propozues, i ka kthyer kryetarit të Bashkisë. Brenda kësaj letre këmbimi mund të gjeni shumë mirë arsyetimin e këtij propozimi për këtë pikë të rendit të ditës por edhe për pikën paraardhëse, pikën 10-të, që ne e tërhoqëm. Në datën 19.05, Kryetari i Bashkisë Fier, I ka bërë një kërkesë për informacion dhe vënien në dispozicion kryetarit të këshillit të bashkisë Fier. Bashkia Fier, pasi u njoh me shkresën nr. 6318, të datës 18.05.2026, me lëndë 'Njoftim për mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak', ku është njoftuar thirrja e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak Fier më datë 28.05.2026, ora 11:00, ku është përcaktuar rendi i ditës së mbledhjes, parashtron kërkesën si më poshtë vijon: 'Në lidhje me pikën 10 dhe 11 të rendit të ditës, pikat në rend të cilat nuk janë propozuar... nga kërkuesi. Kërkojmë informacion se nga kush janë propozuar këto dy pika të rendit të ditës, si dhe vënien në dispozicion të akteve administrative përkatëse për këto dy pika të propozuara, në mënyrë që të shprehet qëndrimi nga ekzekutivi i Bashkisë Fier. Dhe kryetari i Këshillit, në konsultim me kryesinë dhe grupin e propozuesve, i kthen këtë përgjigje kryetarit të Bashkisë, Z. Armando Subashi: 'I nderuar Z. Kryetar...

Z. Melsi Bogdani

Niku, të lutem, specifiko vetëm pikën 11, sepse pika 10 u tërhoq. Për pikën 10 e gjithë procedura ka shkuar pranë Kryetarit të Bashkisë dhe do të jepet mendimi. Por vetëm për pikën 11, ku jemi aktualisht.

Z. Kreshnik Dapi

Përgjigja për shkresën tuaj me nr. 6362, protokollin e datës 19, përmes së cilës kërkoni informacion dhe vënien në dispozicion të akteve administrative për pikat 10 dhe 11 të rendit të ditës, për mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak më datë 28... vërejmë me keqardhje se kërkesa juaj paraqet një qëndrim kontradiktore dhe të pasinqertë institucionalisht. Përtej faktit që shkresës suaj i mungon krejtësisht citimi i bazës ligjore, ajo që mbetet thellësisht shqetësuese është se Ekzekutivi ka pasur dijeni të plotë, të hershme dhe të detajuar për të dyja këto çështje, duke zgjedhur rrugën e heshtjes administrative ose të zbatimit të mangët të ligjeve.

Në respektim të parimit të transparencës dhe të drejtës suaj ligjore për të shprehur një qëndrim për çdo projektvendim, sipas nenit 64, pikës... nr. 139/2015 për Vetëqeverisjen Vendore, ju sqarojmë kuadrin procedural si vijon:

Në lidhje me pikën 11 të rendit të ditës: 'Projektvendim për shqyrtimin dhe miratimin e kërkesës për pajisjen me zyrë vendore të Partisë Social Demokrate të Shqipërisë'. Kjo pikë përmban kërkesën zyrtare të Partisë Social Demokrate të Shqipërisë, me nr. protokollin 2327, datë 05.05.2026, protokolluar në bashki me nr. protokollin 6278, datë 18.05.2026, dërguar nga selia

qendrore dhe firmosur nga Nënkryetari i Partisë, Z. Altin Vrioni, për sigurimin e një zyre pune për mbarëvajtjen e aktivitetit të këtij subjekti politik. Fakti procedural qëndron sepse ligji për partitë parlamentare dhe zbatimi i mangët i tij nga ana juaj qëndron, se ky subjekt politik i është drejtuar institucionit tuaj direct dy herë me shkresë zyrtare me nr. protokollit 2170, datë 13.10.2023 dhe 2303, datë 18.08.2025, duke u mjaftuar me dërgimin e zbatimit të dispozitave të ligjit nr. 8580 për partitë politike, të ndryshuara, që rregullon detyrimin e bashkisë për partitë parlamentare për sigurimin e hapësirave të punës.

Në të dyja rastet, përgjigjet tuaja kanë qenë negative, me këtë numër protokollit: 9223/1, protokolluar më datë 18.10.2023, dhe 9581/1, protokolluar më datë 01.09.2025. Duke u mjaftuar me deklarin se Bashkia nuk disponon ambiente të lira që i shërbejnë kërkesës suaj, i cili njëkohësisht është dhe opsioni i parë I ligjit .

Ju vëmë në duke se në kthim përgjigjet tuaja ju keni shmangur dhe fshehur qëllimisht opsionin e dytë ligjor, të parashikuar në VKM nr. 255, datë 200.04.2023, i cili detyron shtetin të mbulojë qiranë e ambienteve nga të tretët për partitë parlamentare, nëse nuk kanë ambiente ekzistuese në pronësi.

Kjo shkelje e hapur e parimit të informimit, transparencës dhe përgjegjësisë, veçanërisht e neneve 5, 6 dhe 15 të Kodit të Procedurave Administrative, e detyroi sërish subjektin t'i drejtohej drejtpërdrejt Këshillit Bashkiak si organ suprem vendimmarrës për të garantuar zbatimin e plotë të ligjit me anë të letrës me nr 2327 prot të datës 05.05.2026. Sa më sipër, grupi i këshilltarëve, në mbështetje të ligjit 139/2015 neni 54 pika e, hartoi projektvendim nr .51 më datën 18.05.2026 .Si përfundim të dyja çështjet, si 10-ta dhe 11-ta, për të dyja çështjet, duke futur dhe 11-tën, ju keni shprehur mendimin tuaj. Për çështjen e propozuar në pikën e 11-të, biles e keni shprehur dy herë me qëndrime negative.

Në zbatim të parimit të transparencës absolute që ky këshill aplikon në mënyrë të palëkundur, bashkëngjitur kësaj shkrese ju vihen në dispozicion të gjitha materialet e depozituara. Që do të thotë që ekzekutivi i bashkisë për herë të tretë është vënë në dijeni po ashtu dhe këshilli bashkiak, është plotësuar me gjithë dokumentacionin e nevojshëm. Kërkesa e subjektit tim plotëson të gjitha kriteret dhe të ligjit dhe të VKM-së, dhe unë I ftoj kolegët ta votojnë këtë pikë sepse ligji dhe VKM-ja nuk janë , sin ë rastin e kryetarit të bashkisë, për opinion. Ato janë të detyrueshme dhe duhet të zbatohen nga të gjithë

Z.Melsi Bogdani

Shumë faleminderit Niku. Po, avokati?

Z.Gëzim Hajdëraj

I nderuar kryetar! Unë i dëgjova diskutimet e kolegut. Më duket sikur, me shqyrtimin e kësaj kërkesë, po merremi me shqyrtimin e pjesës politike dhe jo asaj ligjore. Vetë fakti që kolegu


Endri thotë: Shkoni në gjykatë administrative, ka një gjë që nuk shkon. Tani unë si anëtarë i Këshillit Bashkiak më intereson që vendimmarrjet e Këshillit Bashkiak të bëhen në përputhje me dispozitat ligjore dhe nuk më intereson asnjë gjë tjetër. Vetë fakti që këtu pranohet të diskutohet për ligj dhe a është kjo kërkesë e bazuar në ligj apo jo, do të thotë që nuk i takon Këshillit Bashkiak të jetë organ që të merret me trajtimin e saj. Kështu që unë mendoj që në thelb kjo kërkesë është e pabazuar në ligj dhe nuk duhet pranuar. Në vendimin e qeverisë me nr. 255 datë 20.04.2023 të firmosur nga zv.kryeministrja Belinda Balluku, është e përcaktuar fare qartë në pikën 2 që kompetent për zgjidhjen e kësaj kërkesë është MB dhe kryetari i bashkisë. Nuk arrijë ta kuptoj këtë këmbëngulje evidente që kur ligji është kaq i qartë në raport me një organ të caktuar, si mundet që ky këshill të dali mbi ligjin, çfarë jemi ne? Unë nuk e jap kurrë votën time për një vendim që është jashtë ligjit dhe atëherë unë mendoj që nqs ky ligj është i qartë dhe, nuk dua të zgjatem se ka edhe pika të tjera, ka afate të përcaktuar vendimi i qeverisë që ngarkon kryetarin e bashkisë dhe MB të merret me dhënien e selive të partive të ndryshme. Natyrisht në parim, nuk është se jam unë kundër, por të gjitha partitë duhet të pajisen me seli, por zgjidhja procedurjale ligjore është organi përkatës. Nqs nuk e kryen detyrën ai, atëherë sipas ligjit, organit përkatës I kërkohet vënia përpara përgjegjësisë, në gjykatë administrative, në prokurori e kudo. Në këtë vendim qeverie, sikurse e thashë, të cilin e ka firmosur zv.kryeministrja, është përcaktuar fare qartë të gjitha hapat që ndërmerr MB ose kryetari i bashkisë me afate të përcaktueshme. Nqs është jashtë afateve, atëherë kërkuesi ka të drejtë të vijë në këshill e të kërkojë masa ndaj kryetarit të bashkisë, që nuk ka zbatuar ligjin, ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës administrative, që ta detyrojë që ta zbatojë ligjin, ka të drejtë t'i drejtohet prokurorisë që ta marrë në përgjegjësi penale, për moszbatimin e ligjit. Unë kështu e konceptojë për vete dhe unë do të votoj kundra këtij projektvendimi.

Z.Melsi Bogdani

Shumë falënderit, avokat! Kush e do fjalën? Po Neta.

Znj. Antoneta Çunaj

Ashtu siç e përmenda unë më para, e thashë se jam kundra kësaj pike të rendit të ditës pikërisht sepse... sepse Këshilli Bashkiak mblidhet për të miratuar apo për të bërë projektvendime dhe vendime, vetëm kur janë në përputhje me ligjin. Në qoftë se një projektvendim vjen në kundërshtim të hapur me ligjin dhe aq më tepër që VKM-ja nr.255 ku e ka mbështetur kërkesën



PSD-ja të datës 20.04.2023 e thotë në mënyrë të qartë se kush është subjekti për të bërë një e paligjëshme veprim të tillë, unë mendoj që kërkesa duke qënë haptaz e paligjëshme, nuk ka pse nga ana e këshillit bashkiak Fier, që nuk ka ndodhur asnjëherë, një kërkesë të jetë haptaz e paligjëshme, të miratohet në këshill. Mgjth gjithësecili mban përgjegjësinë e vet. Kjo unë mendoj që nuk është fare kompetencë e këshillit, kjo është kompetencë e kryetarit të bashkisë, siç e ka dhe VKM-ja. Nqs kryetari I bashkisë, nëse PSD-ja ka ndonjë informacion që kryetari I bashkisë ka zyra, nuk do, ose ka arsye të tjera, e vetmja rrugë ligjore është rruga administrative.

Z.Melsi Bogdani

Shumë faleminderit, Neta! Po Niku.

Z.Kreshnik Dapi

Çështja e ligjit i takon personave kompetent që ngarkohen për ta interpretuar dhe për ta zbatuar. Më vjen keq për kolegen se ajo i bëri lëmsh me mbiemra, me ligje, me rregullore dhe nuk po futem shumë, por ligji e thotë qartë dhe VKM-ja që ngarkohet kryetari i bashkisë, dhe kush do mund të hyjë dhe ta lexojë ligjin, të zbatojë këtë VKM-në, nuk thotë se është autoritet ekskluziv, gjithashtu siç të gjithë e dimë pronarë i aseteve dhe pronave të qytetit është këshilli bashkiak. Ne kemi parë që kryetari i bashkisë këtu vjen për të dhënë me qira qindra hektarë toka për fotovoltaikët, mijëra metra katrorë të tjerë për lloj lloj qëllimesh, të drejta ose të padrejta, godina dhe ndërtesa të ndryshme. Pra këshilli bashkiak nuk fund është vendimarrësi se çdo të ndodhi me pronat dhe asetet e bashkisë Fier, dhe kjo kërkesë mbështetet totalisht në ligj. Hallka pasardhëse është Prefekti i Qarkut, që shumë mirë mund të japi mendimin për vlefshmërinë e këtij projektvendimi.

Z.Melsi Bogdani

Shumë faleminderit, Niku! Për ta mbyllur kush e do fjalën? Po Niko.

Z.Niko Neço

Kjo pikë ka ardhur si pikë e rendit të ditës e propozuar nga këshilltarët e këshillit bashkiak Fier. Unë doja të parashtroja disa konsiderata në emër të ekzekutivit përse I takon rastit konkret, që do të thotë që kërkesa me numër 2327 datë 05.05.2026 protokolluar pranë bashkisë fier sipas protokollit dhe datës përkatëse, është duke u trajtuar nga administrata, nga kryetari I bashkisë,

siç e përcakton VKM-ja nr.255 datë 20.04.2023, dhe të paktën referuar shkresave konkrete që kemi administruar, kryetari I bashkisë I është drejtuar me shkresë zyrtare PSD-së ku I është kërkuar plotësim dokumentacioni

Z.Kreshnik Dapi

Ç'farë date?

Z.Niko Neço

20.05.2026

Z.Kreshnik Dapi

Që do të thotë pas publikimit të rendit të ditës.

Z.Niko Neço

Unë po I referohem akteve shkresore

Z.Kreshnik Dapi

Citoje të gjithë kronologjinë

Z.Niko Neço

Në funksion të informacionit për rendin e ditës, të gjitha ato që ka administrata, ku i kërkon plotësimin kumulativ të dy kërkesave që janë parashikuar në VKM-në nr 255, siç është 1:Për vërtetim nga KQZ-ja për mesataren e votave të partisë konkrete deri në zgjedhjet e fundit parlamentare dhe 2:Vërtetim nga kuvendi i Shqipërisë për numrin e vendeve që ka partia përkatëse në kuvend. Këto janë pasazhe të marra nga VKM-ja përkatëse. Kështu që në funksion të plotësimit të praktikës, kjo është një praktikë që është në shqyrtim e sipër.

Z.Kreshnik Dapi

Të lutem kryetar, mundem?

Z.Melsi Bogdani

Po, Niku.

32

Z.Kreshnik Dapi

Atëherë, për sa I përket kthimit të përgjigjes nga ana e kryetarit të bashkisë, ajo ka qënë e vonuar, dhe më saktë ka qënë e keq adresuar, sepse letra që citoi zotëria nuk I është drejtuar kryetarit të bashkisë, e datës 5 maj, ajo I është drejtuar këshillit bashkiak dhe këtu dalim tek ai problem që thashë qëparë për protokollin. Unë e kam kërkuar atë letër ku ka vajtur, për 3 javë rrjesh dhe na kish përfunduar me qëllim apo pa qëllim në një zyrë që sikshte lidhje fare me letrën. Tani për pjesën e vërtetimeve që citoi, në respekt të transparencës, të gjithë këshilltarët I kanë të skanuara në EhatUp vërtetimet në fjalë, dhe komisioni dhe këshilli janë njohur me të gjitha vërtetimet që kërkon ligji.Faleminderit!

Z.Gëzim Hajdëraj


O zoti kryetar?

Z.Melsi Bogdani

Po.

Z.Gëzim Hajdëraj

Mqs është fushë e ligjit, dhe ne si njohës së tij, na vjen keq që kjo pikë po trajtohet në këtë mënyrë. Tani nqs kryetari I bashkisë nuk zbaton ligjin, mban përgjegjësi dhe çdo parti ka të drejtë dhe çdo individ , çdo anëtarë këshilli ka të drejtë t'I drejtohet këshillit për marrjen e masave. Tani, kolegu I nderuar Niku, ka shumë të drejtë që duhet të pajisen me, sipas ligjit, partia e tij me seli dhe unë jam plotësisht dakort në parim që kjo duhet të bëhet. Duhet I dhënë mundësia çdo lloj partie, çdo lloji individi përfaqësues I forcave politike të ketë mundësi praktike që të ushtrojë aktivitetin partia, nuk kemi asnjë kundërshtim. Tani problem shtrohet tek procedura, tek mënyra. Tani mënyra se si zgjidhet një kërkesë, është caktuar në ligj, edhe për partitë politike, kushdo që të jetë. Tani ky ligj ja ku është, partitë politike thotë I drejtohen me kërkesë MB ose kryetarit të bashkisë. Tani unë nuk e kuptoj çfarë ka nevojë këtu për interpretim?Tani ata që janë jurist, ose që kanë njohuritë më fillestare të jurisprudencës e kuptojnë. Këtu nuk lë vend, s'ka vend këtu për ekuivok. Ne nuk jemi shtojcë, do të kompesojmë letrat partiake apo luftën partiake. Ne jemi anëtarë këshilli dhe zbatojmë ligjin dhe marrim vendime në bazë të ligjit. Nqs kolegu më thotë mua, se mori në përgjithësi, se këshilli bashkiak

 33

vendos kështu-kështu, këshilli bashkiak vendos në bazë të ligjit, nuk vendos këshilli bashkiak jashtë ligjit. Dhe nëq jo, marrim ligjin për pushtetin vendor nuk ka absolutisht në asnjë pikë atje që këshilli vendos për selitë e partive politike. Edhe po të shikosh përmbajtjen e relacionit që ka ardhur bashkë me kërkesën, është e njëjta gjë, është kopjuar ky vendim qeverie, firmosur nga zv.kryeministja, pra i ngarkon detyrat që ia ka ngarkuar ligji. Tani për çfarë jemi në këtu? Do të përsërisim ligjin? Jemi parlament në? Tani kur ligji e ka të përcaktuar, aktin nënligjor në fakt, e ka të përcaktuar, tani çfarë do të bëjmë në? Çfarë thoni? Çfarë do të vendosim në? Prandaj duhet trajtuar me gjakëftohtësi dhe pa pasione politike problemet politike. Kjo kërkesë duhet të shihet nëq është e ligjshme apo jo e ligjshme. Nëq është e paligjshme, që për mendimin tim është, i ftoj të gjithë kolegët të mos e votojnë. Nëq mendojnë që është e ligjshme, e bazuar në ligj, le ta votojnë. Por kur ligji e thotë shprehimisht o MB o kryetari i bashkisë në s'kemi punë fare këtu.

Z.Melsi Bogdani

Shumë faleminderit! Po inxhinier çfarë kishit? Që ti jap fjalën kryetarit të grupit dhe ta mbyllim këtë pikë.


Z.Ilia Fili

Shiko, unë mendoj kështu. Natyrisht që partitë parlamentare kanë shumë të drejtë që kërkojnë ambiente në qytet dhe ata që folën ishin njohës të ligjit dhe ata i referohen kësaj linje kështu, mirëpo janë dy Ristan këtu mbrapa, që po thonë që në po shkelim ligjin. Propozimi im është, që propozimi i PSD-së, t'i kalojë zyrës juridike të bashkisë tek juristët e specializuar dhe të na i sjellin ata mbledhjen tjetër me vendim të prerë të zyrës juridike, i takon këshillit apo nuk i takon këshillit, sepse juristët tanë që janë në këtë sallë dhe fatmirësisht janë anëtarë këshilli, flasin ndryshe, ata i referohen ligjeve që thonë po ka të drejtë që të shqyrtohen në këshill. Tani në që nuk jemi jurista, jemi para një situatë që nuk dimë se çfarë vendimi të marrim. Por zyra më efiçase që është për këtë problem, unë mendoj se është zyra juridike. Atëherë ky propozim t'i shkojë zyrës juridike, dhe ata t'a ndajnë, i takon kryetarit të bashkisë apo i takon këshillit.

Z.Melsi Bogdani

Shumë faleminderit, inxhinier! Po kryetar.

Z.Armando Subashi



Faleminderit! Unë i dëgjova në fakt të gjitha argumentat e këshilltarëve, dhe lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, dua të bëj disa shtesa. Së pari, ne si ekzekutiv dhe unë posaçërisht si kryetar bashkie, nuk jam dakort me mënyrën dhe procedurën që është ndjekur me futjen e kësaj pike në rendin e ditës, në mbledhjen e këshillit bashkiak. E gjithë veprimtaria e ekzekutivit, dhe e këshillit, bazohet në ligjin për pushtetin vendor. Sigurisht ka dhe një rregullore të miratuar për mënyrën se si funksionon këshilli. Por aty ku rregullorja ka mospërputhje me ligjin, nesoj është e qartë për të gjithë dhe s'ka nevojë për ta thënë unë, prevalencë merr ligji, aq më tepër që ky është një ligj me shumicë të cilësuar me 3/5 në parlament, dhe ky ligj merr prevalencë edhe në raport me ligje të tjera, që miratohen me shumicë të thjeshtë, jo më me një rregullore që mund të ketë miratuar një këshill bashkiak, siç është këshilli ynë. Mbi këtë bazë në referim të nenit 53 të ligjit për pushtetin vendor, thotë: Këshilli bashkiak ushtron funksionet e tij nga data e kostituimit sipas nenit 48 të këtij ligji, deri në krijimin e këshillit të ri pasardhës. Pika 2: Mbledhjet e radhës të këshillit bashkiak, zhvillohen si rregull, sipas përcaktimit që bën vetë këshilli, por jo më pak se një herë në muaj, çka do të thotë që pavarësisht problematikave, të paktën këshilli një herë në muaj duhet të mbledhet, pastaj, mbledhet dy herë, tre herë, pesë herë, gjashtë herë brenda muajit, kjo besoj që nuk është problem dhe është kompetencë e këshillit në varësi të gjithë pikave apo diskutimeve që mund të ketë nevojë për tu diskutuar në këshill. Pika tre: Këshilli mbledhet në çdo rast, pavarësisht pikës një dhe dy, këshilli mbledhet në çdo rast a) me kërkesë të Kryetarit të Bashkisë, b) me kërkesë me shkrim nga të jo më pak se 1/3 së anëtarëve të Këshillit, dhe c) me kërkesë të motivuar të Prefektit për ato çështje që janë në funksion apo kompetencë të Prefektit.

Kjo do të thotë që, nëse kërkohet një mbledhje e Këshillit Bashkiak nga Kryetari, një e treta (1/3) e anëtarëve, ose Prefekti, sigurisht që kërkesa nuk bëhet pa përcaktuar ose pa u shprehur se për çfarë do mbledhet. Sepse nuk mund të kërkohet thjesht 'hajdeni mbledhemi në Këshill' dhe 'bëjmë muhabet', por do të diskutohet për këtë apo për atë temë. Pra, mbledhja e Këshillit, pavarësisht nga kush e kërkon, ai që e kërkon ka detyrimin që të përcaktojë edhe pse duhet mbledhur Këshilli.

Kush janë pikat e rendit të ditës që do të diskutohen në Këshill?

Në rastin konkret, pavarësisht se është përcaktuar që në fund të çdo muaji do të ketë mbledhje Këshilli, por rendi i ditës në një lloj kuptimi është me detyrim përcaktim, ose nga Kryetari i Bashkisë, ose nga një e treta (1/3) e këshilltarëve. Nuk ka mënyrë tjetër për të futur një pikë në rend të ditës në mbledhjen e radhës të Këshillit.

Unë jam shumë dakord që, nëse ka një mbivendosje, pra ka dy kërkesa të njëkohshme, kërkon edhe Kryetari i Bashkisë, kërkojnë dhe një e treta (1/3) e këshilltarëve të bëjnë mbledhje, ku ky ka këto pika të rendit të ditës dhe 1/3 mund të ketë këto pika që diskutuam, shumë mirë këshilli apo qoftë dhe kryesia mund t'i bashkojnë në një mbledhje të vetme, s'ka problem, dhe duke thënë, kjo është kërkesa e kryetarit të bashkisë apo ekzekutivit dhe kjo është kërkesa e 1/3 të këshilltarëve, dhe nqs përputhen këto mundet t'i bashkojë në një mbledhje të vetme, që të mos bësh dy mbledhje

35

Por, asnjëherë nuk futet një pikë në rend të ditës jashtë kërkesës së Ekzekutivit, në rast se nuk kërkohet edhe nga 1/3 e anëtarëve të Këshillit. Kjo vlen edhe për rastin konkret, është futur në rend të ditës me firmë të pesë apo gjashtë këshilltarë... pavarësisht se ndër ta është Kryetar i Këshillit, nënkryetari i këshillit, është ajo që quhet kryesia. Por në fund të fundit ligji për qeverisjen vendore, ndryshe nga nenet, po shikojmë aty, për Këshillin e Qarkut... tek këshilli i Bashkisë nuk e njeh fare konceptin e Kryesisë. Njeh Kryetarin e Këshillit, njeh dhe Kryetarin e bashkisë, njeh dhe këshillin. Ndërsa te Këshilli i Qarkut, po të shikoni, veç Këshillit të Qarkut ka edhe Kryesi të Këshillit të Qarkut, që ka kompetenca, që ia ka dhënë ligji, ka dhe Kryetarin e Këshillit të Qarkut se dhe ai ka kompetenca që i ka dhënë ligji. Ndërsa në Këshillin e Bashkisë, Kryesia është një organ që është krijuar në bazë të një rregulloreje për të normuar, për të rregulluar, për të disiplinuar, dhe për ta ndihmuar Këshillin Bashkiak në funksionin e tij. Por kurrsesi, Kryesia nuk mund të marrë kompetenca te Kryetari i Bashkisë apo tek 1/3 e këshilltarëve, dhe me iniciativën e vet të fusë pika në rend të ditës, për t'u shqyrtuar nga Këshilli i Bashkisë. Kështu që nga pikëpamja procedurale, mendoj që ky është momenti i parë ku ky projektpropozim, që ka ardhur për tu miratuar sot, është në kundërshtim të hapur me ligjin, dhe nga ana e Kryesisë nuk duhet të futej për diskutim, për miratim, pa u siguruar 1/3 e këshilltarëve, sepse Ekzekutivi nuk e ka propozuar, dhe 1/3 nuk e ka propozuar, atëherë si është futur në rend të ditës? Kjo mendoj se është një moment që Kryesia edhe për mbledhjen e radhës duhet të reflektojë dhe ligjin në fuqi duhet ta shikojë me shumë, shumë kujdes, sepse një vendimmarrje e bën absolutisht të pavlerëshme, jo vetëm kur përmbajtja e saj është në kundërshtim të hapur me ligjin, siç u tha dhe këtu edhe nga një pjesë e këshilltarëve, por edhe kur procedura që ndiqet për futjen në rendin e ditës për diskutim apo për miratim, është në kundërshtim të hapur e flagrant me ligjin. Kjo është e para.

E dyta, po t'i referohemi VKM 255 të datës 20.04.2023, besoj se është një vendim që është shterues në mënyrën se si e ka përcaktuar të gjithë procedurën e vendimmarrjes së paisjes me zyra të partive politike. Dhe momenti i parë është: Për selitë qendrore i drejtohet ministrisë përkatëse, për selitë vendore i drejtohet bashkisë, dhe kur themi bashkisë kuptohet që Bashkia, siç e thotë ligji, përfaqësohet nga kryetari i saj. Në këtë pikëpamje, kjo kërkesë është bërë edhe herë të tjera, dhe ne me vonesë apo pa vonesë, i kemi kthyer përgjigje kur u kemi thënë që Bashkia nuk disponon ambiente të lira për t'i dhënë me qira për zyra partive politike. Ne sot, momentalisht, jemi në vështirësi vetë, kemi mjaft drejtori, edhe këtu në këtë godinë që po flasim, kemi shumë drejtori, me shumë specialist, që rrinë nga 4 nga 5 veta në një zyrë, dhe realisht është e vështirë puna e përditëshme që bëhet. Kemi disa drejtori që jemi munduar të shfrytëzojmë objekte apo godina të tjera që janë në pronësi të bashkisë, ku kemi nxjerrë jashtë kësaj godine, duke filluar nga drejtorja e pyjeve, e veterinarisë e mjeksisë, IVMT-ja dhe shumë drejtori të tjera ku realisht dhe këtë e them, zyrat ku ato punojnë nuk janë për hirë të së vërtetës, të atij standarti, ku punohet në këtë godinë ku jemi sot në mungesë të ambjenteve në këtë godinë, sigurisht ne kemi qënë të detyruar që të sigurojmë ambiente të tjera pune, ndofta jo me kushtet që janë këtu. Dhe në këtë pikëpamje, unë po e përsërisë prapë, sot që flasim ne nuk kemi ambiente të lira për t'ia vënë në dispozicion partive politike. Nëse në një moment tjetër, për shkak të rrethanave të

caktuara, për shkak të një investimi që mund të kryhet etje na krijohen kushte apo ambiente, pse jo. Ne jemi të gatshëm që mund t'ja japim edhe partive politike, se në fund të fundit me qira do ta marrin, nuk do t'i marrin falas, dhe vendimi i qeverisë pak a shumë ka përcaktuar edhe tarifën e qirasë. Por pse kërkohet me doemos që zyrat të gjenden nga bashkia, dhe lekët të jepen nga bashkia, se ky është edhe absurditeti më i madh pastaj, që e bën të kundraligjshëm të gjithë këtë histori. Pra, nëse bashkia ka zyra të lira, po patjetër në parim ne jemi dakort t'i japim...

Z.Kreshnik Dapi

Kryetar, me leje?

Z.Melsi Bogdani

Ja një second, të mbarojë kryetari, të lutem!

Z.Armando Subashi

Ne jemi dakort t'i japim dhe kundrejt tarifave që përcakton VKM-ja, të lidhim dhe kontratat. Por nëse nuk kemi ambiente të lira, prapë VKM-ja e ka zgjidhur, nuk i ka lënë partitë politike pa zyra. Si e ka zgjidhur? I ka thënë, gjeni ambiente me qira, deri në 50 metra katrorë për zyrat vendore, lidhni një kontratë qiraje, të mobiluara deri në 1000 lekë për m², të pa mobiluara deri në 750 lekë për m², sillni kontratën e qirasë, dhe paguhet nga buxheti i shtetit, sipas përcaktimeve që do të bëjë vetë KQZ-ja, dhe thotë VKM-ja, po ta lexoni, edhe këto shpenzime thotë përballohen nga buxheti i shtetit nëpërmjet fondit që shteti u jep partive politike për ushtrimin e aktivitetit të tyre. Pra nëq PSD-ja, si partia parlamentare, ka marrë X lekë nga buxheti i shtetit, për të ushtruar funksionin e vetë në qendër dhe në rrethe apo në bashki në territor, shumë mirë, një pjesë të buxhetit që shteti i ka dhënë për këtë funksion, le të paguajë zyrën, nuk ka asnjë problem këtu. Pra kjo është gjë e zgjidhur dhe nuk ka punë këtu bashkia, se nuk kemi pse ndihemi ne "përgjegjës", që t'i sigurojmë zyrë patjetër një partie politike, ska lidhje me ne fare. Ne po të kemi ambiente, bujrum, hade merre me qira, vazhdo punën. Po s'kemi, s'jemi përgjegjës dhe këtu mbyllet historia jonë me partitë politike, nuk kemi detyrim tjetër. Edhe VKM-ja e thotë shqip: Nëse ka, shumë mirë, jepja, bëjë kontratën e qirasë, vazhdo punën, nëse s'ke, ktheji përgjigjen që s'ke dhe partia të vazhdoi punën me privat dhe le të gjejë ku të dojë zyra. Ne nuk mund të nxjerrim punonjësit tanë nga zyrat, të boshatisim drejtoritë, t'i bëjmë nga 7 veta në zyrë punonjësit dhe t'i japim zyrë partive politike, sepse kështu mund të jenë edhe parti të tjera dhe mund të kërkojnë edhe ato zyra, s'është vetëm PSD-ja, janë edhe shumë parti të tjera, që mund të konsiderohen parlamentare ose jo, dhe që shteti ka detyrimin që në një farë kuptimi të futet dhe t'i rregullojë ato me zyra. Prandaj unë ju ftoj që këtë t'a shikojmë me shumë kujdes, prandaj dhe unë u zgjata, nëse doni të gjitha pikat e VKM-së 255 mund t'i lexojmë, dhe besoj nuk ka nevojë që të jesh jurist për të kuptuar që nuk kemi asnjë detyrim ne si bashki.

Z.Endri Jaupaj

37

O kryetar! Ke 4 mbledhje rrjesht që nuk vjen, dhe ke ardhur I përgatitur për një gjë të tillë, je I zgjedhur...

Z.Melsi Bogdani

Të lutem o Endri, do ta jap unë fjalën, kërkoje fjalën. O Niku të lutem, të mbarojë fjalën kryetari. Tani në respekt... të lutem, të lutem Endri. Po kryetar!

Z.Endri Jaupaj

Merru me hallet e qytetit...

Z.Armando Subashi

Sa për të ilustruar konkretisht këto që thashë, në pikën 12 thotë : komisioni qëndror i zgjedhjeve, përcakton masën konkrete për fondin publik, që përfiton çdo parti politike në formën e ndihmës financiare vjetore. Fondi publik i miratuar në buxhetin e shtetit, si ndihmë financiare, përdoret nga partia edhe për qira. Pra është shumë e qartë. Ato lekë që të ka dhënë shteti, një pjesë të tyre merr objekte ose godina me qira dhe përdori si zyra.


Pika 16: Efektet financiare për përballimin e shpenzimeve për pagesën e qirave të ndërtesave për selinë qëndrore apo zyrat vendore të partive politike...sipas përcaktimeve të këtij vendimi , përballohen nga buxheti I shtetit në formën e fondit që shërben si ndihmë financiare publike për kryerjen e veprimtarisë vjetore të partisë politike. Pra më shqip dhe më shkoqur se kaq nuk ka, prandaj unë do t'ju ftoj të gjithëve, qoftë për shkak të shkeljeve procedurale, që përmenda në fillim, si pikë që është future në këtë mbledhje në kundërshtim me ligjin për Pushtetin Vendor, qoftë edhe për thelbin dhe brendinë e saj, që bie në kundërshtim të hapur me VKM-në të cilën unë sapo e lexova, ju ftoj që ta rrëzoni këtë pikë. Nuk duhet të ishte future fare në fakt, por mqs është futur ju ftoj që ta rrëzoni. Në rast të kundërt, sigurisht, ne si ekzekutiv do të vazhdojmë të ndjekim gjithë procedurat e mëtejshme që faktikisht na I njeh ligji për ta kontestuar.

Z.Melsi Bogdani

Shumë faleminderit kryetar! Po Niku!

Z.Kreshnik Dapi

Për procedurë duke dëgjuar me vëmendje fjalën e kryetari, dua t'i bëj me dije gjithë kolegëve në radhë të parë për zbatueshmërinë e ligjit pastaj çështja e zyrës është në plan të dytë. Dëgjova kryetarin që e përdor ligjin 139 në funksion të asaj që ai do të arrijë, jo në funksionin e drejtë siç shkruhet ligji. Për ta ditur të gjithë kolegët këtu edhe qytetarët. Rregullorja është ligj më vete që buron nga ligjet 139, 68 e me radhë, që do të thotë nga zbatimi me rigozitet I rregullores së Këshillit Bashkiak nuk përbën shkelje ligji për asnjë vendim apo vendimmarrje të saj. Më qartë tek ligji 136 neni 53 tek pika ku kryetari citoi numrin e 1/3 së këshilltarëve, pika në fjalë thotë

 38

specifikisht për thirrjen e mbledhjes së radhës jo për projektvendimet dhe propozimet. Për projektvendimet dhe propozimet flet qartë rregullorja që ka buruar nga ky ligj, dhe për këtë gjë, rregullorja e këshillit Bashkiak është dokumenti juridik që ka të dyja votimet e legjislativit në Shqipëri, të Parlamentit, pasi është ratifikuar në Parlament dhe është edhe vendim i Këshillit Bashkiak, pasi bashkërisht e kemi votuar. Neni 53 I rregullores së Këshillit Bashkiak, pika j), kompetencat dhe detyrat e këshillit bashkiak miraton tjetërsimin ose dhënien me qira të pronave tek të tretët që do të thotë...

Znj. Antoneta Çunaj

Sa zgjat kjo procedura se po na tregon ligjin një që s'ka qënë asnjëherë jurist dhe s'ka punuar. Ti do të na mbushësh mendjen në që kemi nga 35 vjet avokat. Tani ne nuk jemi këtu për të lexuar rregullore, kryetar. Sa do të zgjasi kjo procedurë se do të votojmë, do të ikim se kemi punë.

Z. Melsi Bogdani

O Niku të gjithë ne këtu e kemi para syve. Unë kam edhe ligjin përpara syve edhe rregulloren dhe jam lexues më se i rregullt edhe i ligjit edhe i rregullores, të lutem! Konkludo në pikën 11 që ta mbyllim. T'i jap fjalën komisionit që është mbledhur dhe ta mbyll.

Znj. Antoneta Çunaj

Nuk mund të votohet, është shkelje ligji. Kush bën shkelje ligji, shkon në burg.

Znj. Brunilda Hoxha

Mos I bëj presione të tilla presione, Këshillit Bashkiak të qytetit tonë.

Z. Melsi Bogdani

Neta të lutem! Bruna të lutem!

Z. Kreshnik Dapi

Edhe kur citon VKM-në 255, kryetari nuk e citon siç duhet. Kryetari i bashkisë ka dërguar dy herë letër që për hirë të së vërtetës nuk e ka firmosur vetë, e ka firmosur një herë një zonjë dhe një herë një zotëri

Z. Melsi Bogdani

Nuk i hyjmë fare këtyre aspekteve ne.

Z. Kreshnik Dapi

39

Unë dua një vërtetim nga ASHK-ja dhe inventarin ligjor të të gjitha pronave të bashkisë, kështu që administrata dhe kryetari e ka shkelur vetë me të dyja këmbët ligjin.

Z.Melsi Bogdani

Shumë faleminderit! Komisioni u mbledh për këtë pikë?

Znj.Erlinda Llupi

Po përshëndetje! Komisioni u mbledh dhe e kaloi për miratim.

Z.Melsi Bogdani

Atëherë nqs nuk ka diçka tjetër për të diskutuar, e hedhim në votë shqyrtimin dhe miratimin e kërkesës për pajisje me zyrë vendore të PSDSH-së ? Kush është dakort?Sekretar numëroni pak votat të lutem.

Z.Ilia Fili

Kryetar, kam vetëm një gjë.

Z.Melsi Bogdani

Po.

Z.Ilia Fili

Më kuptoni drejtë. Këtu po thonë juristët që ka shkelje. Ju po hidhni në votim një gjë që ka shkelje?

Z.Melsi Bogdani

Inxhinier! Unë po shqyrtoj rendin e ditës mbi ato që unë e lexoj ligjin dhe rregulloren.

Z.Ilia Fili

Unë jam pro ligjit, por jo kështu.

Z.Melsi Bogdani

Ka institucione më lart që e kthejnë vendimin.

Z.Ilia Fili

Këtu po thuhet që ka shkelje ligji. Çfarë do të bëhet me mua? Si ta ngre dorën unë? Pse po ngutemi.

Z.Melsi Bogdani

Inxhinier, të lutem! Kjo pikë, ne e kemi kaluar rendin e ditës.

Z.Ilia Fili

Unë bëra një propozim shumë realist.E shtyjme një muaj dhe zyra juridike të flasi me përgjegjësi që i takon këtij këshilli apo nuk i takon.

Z.Melsi Bogdani

Të lutem se e hodha në votë.Mqs u fut në rendin e ditës, ne do të zbatojmë pjesën e rregullores. Kush është dakort që ta mbyll.Numëroi pak votat, të lutem!

Z.Arnando Çupa

Kryetar, të lutem për votimin. Numëro votat pro pastaj të bëhet votimi kundër dhe abstenim.

Z.Melsi Bogdani

Po.Kush është pro? 22 vota pro.Kundra? 2 kundra. Abstenim? 3 vota.

Z.Arnando Çupa

Ishin 3 vota kundra

Z.Melsi Bogdani

Edhe njëherë, më thuaj pjesëmarrjen në sallë, të lutem sa është aktuale?


Znj.Antoneta Çunaj

Dale të ngrenë votat, kush është pro.

Z.Melsi Bogdani

I numëroj unë votat, Neta, që këtu.Sa është pjesëmarrja në sallë totale e këshilltarëve në këtë minut?

Z.Arnando Çupa

A series of handwritten signatures in blue ink, including a large signature on the left, a smaller one in the middle, and a large one on the right. A small number '41' is written above the middle signature.

26 është pjesëmarrja .

Z.Melsi Bogdani

Jo s'është aq, është më shumë.

Znj.Antoneta Çunaj

U votua, 22 janë. Çfarë do të bëni? Do të ndryshoni procesverbalin e votimit? Se këtë nuk e kuptoj.

Z.Melsi Bogdani

Të lutem Neta!

Z.Arnando Çupa

28

Z.Melsi Bogdani

28 janë në sallë. 22 pro, 3 abstenim, 3 kundër. Si e ka kjo të përcaktuar? E ka me shumicë të thjeshtë të pranishmëve në sallë apo 50+1?

Z.Arnando Çupa

Pikat e rendit të ditës janë të gjitha me shumicë të cilësuar. Pra dhe në rastin konkret duhet të jetë 50+1% të numrit të përgjithshëm të këshilltarëve.

Z.Melsi Bogdani

Atëherë pika 11 ka 22 vota pro, 3 vota kundra, 3 vota abstenim., 28 ishin në sallë? E ka 50+1% ? Pra duhen 26 vota pro. Nuk miratohet.

Pro 22 vota

Kundra 3 vota

Abstenim 3 vota

Nuk miratohet.

Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës. Pika e dymbëdhjetë e rendit të ditës. Një sekond. Atëherë me kërkesë, të bëj një përjashtim, sepse më kërkoi inxhinieri leje për tu larguar, dhe të kalojë pikën jashtë radhe të rendit të ditës tani, pastaj të kalojë në shqyrtimin e pikave të radhës të rendit të ditës. Pra të kajojë shqyrtimi për qytetar nderi . Dhënien e titullit qytetar nderi pas vdekjes për anëtarët themelues të grupit të këngës qytetare Fierake

Pika e parë shtesë e rendit të ditës.

Projektvendim: “Dhënien e titullit qytetar nderi pas vdekjes për anëtarët themelues të grupit të këngës qytetare Fierake”

Z.Melsi Bogdani

Duke marrë në konsideratë... jeni dakortë që ta kalojmë tani?

Z.Elvi Daka

Është e vonuar, duhet ta kalojmë.

Z.Melsi Bogdani

Atëherë, duke e marrë në konsideratë propozimin e shoqatës” Bashkimi i Fierakëve në Greqi” Shoqata Apollonia, protokolluar më datë 14.11.2025 me nr. 13030, për shpalljen 'Qytetar Nderi' zotërinjtë Miti Nushi dhe L Lazar Pove, si dhe propozimin e grupit politik të PSD me nr. prot. 5029 datë 21.04.2026, për vlerësimin e personaliteteve të artit dhe të kulturës (për personat e mëposhtëm: Jani Tase, Viron Konomi, Ylli Xherai, Agron Borova) – të gjashtë këta kanë qenë themelues të Grupit të Këngës Qytetare Fierake."

Kryetar, para se ta hidh në votë, kishit diçka?

Z.Armando Subashi

Unë vazhdoj dhe i qëndroj asaj që thashë edhe në rastin e pikës tjetër, normalisht një çështje që futet për diskutim dhe miratim në Këshillin Bashkiak me kërkesë të Ekzekutivit, të 1/3 së këshilltarëve ose të Prefektit. Nëse kjo çështje, që u shty dy herë në fakt sepse ka qenë pjesë e rendit të ditës në mbledhjet e mëparëshme, sot është rifutur prapë në Këshill duke bërë ca shtesa. Nëse shtesat janë me votat e 1/3 së këshilltarëve, unë jam dakord. Nëse shtesat nuk janë me votat e 1/3 së këshilltarëve, për mua kjo shtesë është e jashtëligjshme

Z.Melsi Bogdani



43



Kryetar, kjo pjesë duhet të marri fund, sepse është shqyrtuar dy herë në dy seanca.

Z.Armando Subashi

Kryetar, kjo pjesë duhet të marri fund, sepse është shqyrtuar dy herë në dy seanca. Ajo që është shqyrtuar dy herë, këtu në Këshill, por që këshilli nuk ka arritur të marri vendim, ka qënë një propozim që ka ardhur nga shoqata. Kanë kaluar të gjitha hapat brenda Ekzekutivit të Bashkisë, ku është marrë në shqyrtim nga komisione, nga Drejtoria e Artit dhe e Kulturës, kanë bërë relacionet dhe në fund kemi qënë ne si Ekzekutiv që e kemi sjellë për miratim këtu në Këshill. Pra në referencë të neni 53 të Ligjit për Qeverisjen Vendore, ka qënë një propozim i bërë nga Ekzekutivi. Dhe sigurisht, për sa kohë që Këshilli e ka shtyrë vendimmarrjen dy herë, besoj që për të ndrjerin Jani Tase, për Lllazar Pove dhe për Miti Nushin ka qënë propozimi jonë dhe procedurialisht...

Znj.Brunilda Hoxha

Jo, jo Jani nuk ka qënë I juaji.

Z.Armando Subashi

Procedurialisht unë mendoj që jemi brenda ligjit. Për emrat e tjerë që shtohen, unë nuk kam asgjë kundër, pra nuk jam në parim kundër, nuk jam që të mos i jepet titulli, por jam që nëse duhet bërë një shtesë, të bëhet me propozim të 1/3 së anëtarëve të këshillit siç e parashikon ligji.

Z.Melsi Bogdani

Atëherë komisioni u mbledh për këtë pikë?

Z.Armando Subashi

Nëse jo për mua shtesat që bëhen sot janë të jashtëligjëshme nga pikëpamja procedurale

Z.Melsi Bogdani

Komisioni u mbledh. Po, Bruna para se ta hedh në votë.

Znj.Brunilda Hoxha

Atëherë, të nderuar zonja dhe zotërinj! Ne na ka ardhur një shkresë nga Shoqata e Bashkimit të Fierakëve në Greqi "Apollonia". Kjo shoqatë e cila përfaqëson komunitetin e madh të Fierakëve,

44

që jetojnë dhe punojnë në Greqi, kanë nderin dhe krenarinë të paraqesë këtë propozim zyrtar për shpalljen Qytetar Ndei të Fierit, të artistëve Miti Nushi dhe Llazar Pove dhe jo Jani Tase. Jani Tase nuk ka qënë asnjëherë në listën e tyre. Të lutem mos më ndërprit! Të mbaroj unë, jam unë që po flas tani, kryetarja e komisionit, kur unë të mbarojë më bëj vërejtje, nuk kam asnjë kundërshtim, të lutem! Dy tërë këta personalitete të artit shqipëtar, kanë dhënë një kontribut të veçantë në fushën e kulturës, muzikës, duke qënë ambasadorë të denjë të qytetit të Fierit dhe të vlerave të tyre artistike. Me krijimtarinë, me talentin, përkushtimin e tyre, ata e kanë ruajtur dhe promovuar traditat qytetare Fierake dhe e kanë sjellë këtë në skenat më të rëndësishme të shqipërisë dhe në diasporë. Në vlerësimin e këtij kontributi të çmuar artistic dhe kulturor, propozojmë që Këshilli Bashkiak I Fierit të miratojë dhënien e titullit të lartë "Qytetar Nderi të Fierit" për Miti Nushi këngëtar dhe Llazar Pove këngëtar. Ky titull, do të jetë një shenjë mirënjohje përkontributin e tyre shumë vjeçar, në pasurimin e jetës kulturore të qytetit të Fierit dhe në përfaqësimin dinjitoz të qytetit tonë, Brenda dhe jashtë vendit. Në emër të shoqatës "Bashkimi I Fierakëve në Greqi " Apollonia", ju falendrojmë për vendimmarrjen dhe mbështetjen që I kushtoni vlerësimit të figurave, që I kanë dhënë kontribut të çmuar në qytetin tonë, me respect dhe konsideratë Shoqata e Bashkimit të Fierakëve në Greqi, firmosur nga kryetarja Elida Sopot. Pra këto kanë qënë dy propozimet që kanë ardhur. Duke qënë artistja e qytetit, duke njohur shumë mirë historinë e muzikës së qytetit tonë, përbërja e këshillit tonë është me të rinj, është me një brez të mesëm dhe shumë pak të brezit tim. I prezantova këshillit që radhën e parë, që këta janë pjellë e grupit të këngës qytetare Fierake sepse në veçanti si artista, nuk janë asnjëri nga këta solist. Po ky grup ka lozur një rol shumë të veçantë. Dhe grupi ku këta kanë luajtur, është grupi I drejtuar nga Jani Tase, ku njihet identiteti I muzikës qytetare Fierake me emrin Grupi I Këngës Qytetare Fierake. Dhe ishte mendimi im që së bashku me ta, nuk kemi asnjë vërejtje për Mitin dhe për Llazin, patjetër le të bëhen, por së bashku me kata të bashkohen edhe këta pjestarët e tjerë. Nuk besoj se ka asgjë të keqe. Nqs tin ë Fier pyet këdo që kush është grupi I këngës qytetare fierake, të gjithë gëzojnë respect të madh për këtë grup dhe të gjithë I duan ashtu siç është ky grup. Prandaj zoti kryetar, zotërinj anëtarë të këshillit, kryetar I këshillit dhe të gjithë zotërinjtë nënkryetar, propozimi që ka ardhur nga PSD-ja për t'ju bashkuar edhe këta 4 artistë të tjerë nuk ul asnjë vlerë të dy artistëve të tjerë që do të kenë krahë tyre edhe do të jemi të nderuar përpara qytetarëve fierak e do të na përgëzojnë të gjithë e do të thonë , bravo.Kurse po të ndahen këta të dy do të thonë kush është arsyeja që janë ndarë këta? Ku e kanë

45

arsyen? Lida me gjithë shoqatën e saj, bravo i qoftë, e panë të arsyeshme, e aktivizon Llazin, Llazi ka dhënë për ata, shumë bukur, është një gjë jashtëzakonisht e mirë. Por krahas Llazit dhe Mitit janë edhe këta. Prandaj ky është mendimi që ne ekmi diskutuar edhe në komision sot, dhe kemi rënë dakort që këta të dekorohen të 6-të. Faleminderit!

Z.Melsi Bogdani

Atëherë ka ndokush për të diskutuar? E hedhim në votë?

Z.Gazim Hadëraj

Përpara se ta hedhim në votë, kryetar, vazhdon sipas gjykimit tim ai problem I trajtimit të çështjeve në mënyrë jo ligjore. Veprimtaria e këshillit nuk është veprimtari artistike, ose dashamirëse .Mbledhja e këshillit është ligjore, këshilli vendos sipas ligjit, nuk vendos sipas pëlqimit të njërit apo tjetrit. Dhe unë mendoj që kur trajtohet një kërkesë, duhet parë nga ana ligjore. Në parim, absolutisht nuk besoj se ka njëri këtu, dhe unë aq më tepër që jam më i vjetër se ju, desha të thosha, dhe madje duke njohur disa prej tyre personalisht, dhe një pjesë prej tyre kam dhe marrëdhënie shoqërore dhe jam plotësisht dakort jo vetëm me ata të 6-të por mbase edhe ca të tjerë. por ajo që unë nuk arrij të kuptoj tani, ne jemi dakort por po biem desh për një gjë fare të vogël. Këtu diskutohet nga pikëpamja ligjore, sib ëhet kërkesa në këshill dhe si e merr vendimmarrjen këshilli. Tani kjo është e përcaktuar në ligj, pra kërkesa që këta persona të zgjidhen dhe të marrin statusin duhet bërë ose nga bashkia ose nga 1/3 e këshilltarëve, kaq.

Z.Melsi Bogdani

E ke gabim avokat.

Z.Gazim Hadëraj

Të mbarojë pak unë kryetar? Tani problem është që nqs kërkesa nuk është brenda kuadrit ligjor, pra nuk ka ardhur në këshill nga këta, proceduralisht nuk mund të ketë vendimmarrje këshilli, patjetër. Ne të gjithë jemi dakort, po bëheni kërkesën me 1/3 , e firmos unë I pari, fute në rend të ditës dhe le të zgjidhet ky problem se u bë gangrene ky problem. Tani proceduralisht jemi Brenda ligjit dhe të kënaqen të gjithë dhe është fare e thjeshtë problem. Tani ne bëjmë debat për themelin dhe harrojmë që duhet ruajtur procedura. Zgjidheni sipas procedurës dhe le të votojmë ne të gjithë të marrin statusin.

46

Z.Melsi Bogdani

Atëherë e hedhim në votë dhënien e titullit qytetar nderi të qytetit të Fierit për kontribut të jashtëzakonshme në ruajtjen dhe promovimin e traditës së muzikës popullore qytetare Fierake brenda dhe jashtë vendit duke u shndërrua në identitet kulturor të qytetit për personalitetet si më poshtë: Miti Nushi dhe Llazar Pove propozim i shoqatës bashkimi i fierakëve në Greqi "Apollonia" si dhe Jani Tase, Viron Konomi, Ylli Xherai, Agron Borova. Jani Tase pas vdekjes, Viron Konomi pas vdekjes, Ylli Xherai në gjallje, Agron Borova në gjallje, Miti Nushi dhe Llazar Pove në gjallje. Kush është dakort? Sekretar numëroi pak votat të lutem, se është krijuar një precedent këtu që do ta...por numëroi pak votat. Janë 26 vota pro. Kundra kishte? Abstenim 1 votë

Pro 26 vota

Kundra s'ka

Abstenim 1 votë

Miratohet.

Z.Melsi Bogdani

Kam diçka për të thënë sekretar. Në numërimin për pikën 11 të rendit të ditës, të pranishëm në sallë me sa pashë ishin më shumë se 28 këshilltarë.

Z.Arnando Çupa

Unë aq numërova. Prandaj jeni dhe ju aty që të më kontrolloni sepse vizusi im është i kufizuar nga këtu ku jam.


Z.Melsi Bogdani

Ok. Vazhdojmë me pikën 12 të rendit të ditës.

Pika e dymbëdhjetë e rendit të ditës.

Projektvendim : "Për miatimin e raportit lekniko-ekonomik për dhënien në përdorim të fondit pyjor në pronësi publike të Bashkisë Fier për shtrirjen e linjës së ujës-jellësit Patos"

Z.Melsi Bogdani



Eraldi, ku është nënkryetari?

Z.Armando Subashi

Ka kuorum këtu? Sa veta janë këtu?

Z.Melsi Bogdani

Sa jemi këtu?

Z.Armando Çupa

22

Z.Arben Çuko

Kryetar, bëj thirrje të ulen të mos ikin.

Z.Melsi Bogdani

Të lutem, Elida? Bruna se nuk kemi dhe kuorumin përkatës për pikat e tjera. Ti kalojmë edhe këto tre pika, ti mbarojmë të lutem?Inxhinier, të lutem sepse nuk kemi kuorumi?

Z.Illia Fili

Më ikën avioni, jam I varur nga avioni, me shumë kënaqësi.

Znj.Evisa Sema

Ju thashë , pika 4 duhet t ishte në fund të rendit të ditës.

Z.Melsi Bogdani

Sa jemi?

Z.Armando Çupa

25 me gjithë Lidën.

Z.Melsi Bogdani

Marjus s'kemi më?

Z.Marjus Voja

Këta të tanët janë të gjithë, ikën ata.

Znj.Brunilda Hoxha

Kryetar dhe Lidën se numërove.

Z.Melsi Bogdani

Jo 25 janë .Atëherë pikat e tjera të rendit të ditës do ti kalojmë mbledhjen e ardhëshme. Do ta ndërpresim mbledhjen këtu për mungesë kuorumi. Dakort?

Z.Arnando Çupa

Kryetar deri tek cila pikë u arrit ?

Z.Melsi Bogdani

Deri tek pika e 12-të e rendit të ditës dhe pika jashtë rendit të ditës kaloi.

Z.Arnando Çupa

Pra kemi arritur deri tek pika 11, 12 nuk u miratua.

Z.Melsi Bogdani

12 nuk u miratua.Shumë faleminderit, takohemi në mbledhjen tjetër!

Ky procesverbal ka 49 (dyzet e nëntë) faqe dhe mbahet në tre kopje nga ana e Sekretarit të Këshillit Z. Arnando Çupa.

Sekretar i Këshillit

Arnando Çupa

Kryetar i Këshillit

Melsi Bogdani

